



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:057911

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05682580

PKR.nr.50/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për Krime të Rënda, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova Kryetare e Trupit Gjykues, Sami Sharaxhiu dhe Shaq Curri anëtar të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Bute Ramosaj, në lëndën penale të akuzuarit Sh.G., për shkak të veprës penale të vrasjes nga pakujdesia nga neni 181 të KPRK-së, dhe vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 te KPRK-se dhe të akuzuarit I. C. për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 te KPRK-se, pas mbajtjes së rishqyrtimit kryesor me dt. 28.09.2023, 08.11.2023, 16.11.2023, 29.11.2023, 11.12.2023, 19.12.2023, 31.01.2024, 07.03.2024, 12.03.2024, të hapura për publikun, në prezencë të Prokurorit të shtetit Isuf Sadiku, mbrojtësit të viktimave Luan Mehmetaj, të akuzuarit Sh. G. dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit av. Besnik Berisha, të akuzuarit I.C. dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit av. Veton Berisha, e dëmtuara A.C. mori pjesë në disa seanca gjyqësore, ndërsa nuk prezantuan palët e dëmtuara I. dhe N. T. dhe përfaqësuesit të tyre të autorizuar av. Berat Tmava, ndërsa, me datë 15.03.2024, me shumicë të votave, mori dhe publikisht shpalli, si dhe me datë 16.05.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. **SH.G.**, i biri i H. dhe nenës R. e lindur O., i lindur me ne D., ku dhe banon, ne rrugën "E. Gj". nr .., i pa martuar, ka te kryer shkollën e mesme, student, i gjendjes se mire ekonomike, me tel ..- ...-..., shqiptar, shtetas i Kosovës.

2. **I.C.** i biri i Sh. dhe i N. e gjinisë M., i lindur me date, ne D., ku dhe banon, rruga "E. Gj." nr .., ka te kryer shkollën e mesme, pronar i Kompanisë "G. A." me seli ne D., i martuar, baba i .. fëmijëve, me ID me tel.-..., shqiptar, shtetas i Kosovës.

JANË FAJTOR

I akuzuari Sh.G. Për shkak se:

I.Me datën 23.09.2018 rreth orës 11:05 në D. në rr. “L. H.” në kompaninë “G. A.” nga pakujdesia e privon nga jeta tani të ndjerin A. T. nga fshati Ll. Komuna e D., në atë mënyrë që gjersa i pandehuri ishte duke komunikuar në telefon me N. M.-vajzën e hallës rreth shkuarjes së tij në bjeshkë, duke e porosit që të merr gjësende ushqimore, posa e përfundon këtë bisedë e lëshon telefonin në tavolinë nga karrika në skajin e majte të banakut ku ishte ulur, kalon në karriken tjetër që gjendet në mes të banaku lakohet duke shikuar në anën e djathtë kah dritaret në drejtim të rrugës dhe nxjerr nga sirtari i tretë i anës së djathtë revolen e llojit B. Model, e vendos karikatorin në armë shkrep një herë në drejtim të A. H., A.T. dhe F. Z., të cilët kanë qenë në një distancë 70 cm në mes vete, ndërsa në raport me të pandehurin distanca ka qenë 4 - 5 metra dhe nga kjo shkrepje e godet tani të ndjerin A.T. në mollëzën e djathtë të fytyrës, pas këtij veprim i njëjti e kthen armën ku e ka marrë, duke e kap kokën duke menduar se ka shkrepur me armën me gaz për të cilën paraprakisht e ka njoftuar xhaxhai i tij I. C. se arma me gaz gjendet aty. I njëjti këtë veprim nuk e ka dëshiruar, përkatësisht pasojat shkaktohet kundër vullnetit të tij, si rezultat i mos kujdesit apo indiference apo jo seriozitetit të tij, përkundër përpjekjeve për ofrimin e ndihmës tani të ndjerit A. i njëjti nuk ka mundur ti mbijetoi plagës.

-Me çka ka kryer veprë penale vrasje nga pakujdesia nga neni 181 të KPRK-se.

II. Me dt.23. 09.2018, rreth orës 11:04 min, në D. në rrugën “ L. H. “ nr., në Kompanin G. A., në kundërshtim me Ligjin për armët ka mbajtur në posedim armën dhe atë revolen e tipit B., model, kalibër . mm, me numër serik B....., një karikator të njëjtës armë dhe 11 fishekë në atë mënyrë që me rastin e kontrollit nga policia në sirtarët nën banakun e kasës që gjendeshin në krahun e djathtë është gjetur dhe sekuestruar arma në fjalë për të cilën është konstatuar se i pandehurit nuk ka leje të Organeve kompetente.

-Me çka ka kryer veprë penale mbajtja në pronësi, kontroll ose në posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-se.

I akuzuarit I. C.

Për shkak se:

III. Më parë e gjer me dt. 23.09.2018 rreth orës 14:30 min në D., në shitoren G. A. ka mbajtur në pronësi armë më shkelje të Ligjit të zbatueshëm lidhur më armët dhe atë: pistoletën me gas e tipit B... .. e kalibrit . mm, ..-....., një karikator dhe një fishekë në atë mënyrë që me rastin e kontrollit nga policia në sirtarët nën banaku e kasës që gjendeshin në krahun e djathtë është gjetur dhe sekuestruar arma në fjalë për të cilën është konstatuar se i njëjti nuk ka leje të Organeve kompetente.

-me çka ka kryer veprë penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-se.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 7, 23, 41, 42, 43, 45, 46, 62 par 1. dhe 2 pika 2.7, 73, 74, 80, 83, nenit 181 të KPPRK-se, dhe neni 374 par 1 dhe 3 të KPRK-se, si dhe nenin 364 të KPPRK-se, të akuzuarit i

G J Y K O N

Të akuzuarin Sh. G. për veprën e parë penale si në dispozitivin e parë të cekur si më lart i caktohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite.

Për veprën e dytë penale si në dispozitivin e dytë të cekur si më lart i caktohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite.

Konform nenit 80 të KPRK-se, i caktohet dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vite e 6 (gjashtë) muaj, që do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në këtë dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 23.09.2018 e tutje.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 500€ (pesëqind euro) në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 500 € (pesëqind euro) si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro) të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarit pas shpalljes së aktgjykimit i është vazhduar masa e paraburgimit.

2.Të akuzuarit I. C. për vepër penale si në dispozitivin e tretë të cekur me lart i caktohet dënim me gjobë në shumën prej 2.000 (dymijë euro) të cilën obligohet ta paguaj më së largu në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Në qoftë se i akuzuari dënimin me gjobë të cekur si më lartë nuk dëshiron apo nuk mund të paguaj në afat të caktuar, atëherë i njëjti dënim do të zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 € (njëzet) euro të gjobës.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 300€ (treqind euro) në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 200€ (dyqind euro) si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro) të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Konfiskohen armët B. model kalibër . mm, me numër serik B... .., një karikator të njëjtës armë dhe .. fishekë si dhe pistoleta e tipit B. .. e kalibrit . mm, më numër ..- .. një karikator dhe një fishekë. Të njëjtat pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të shkatërrohen. Të njëjtat gjenden në ruajtje sipas rastit policor-.-....

Të dëmtuarit I. T. dhe N. T., e dëmtuara A. C. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, në këtë gjykatë ka ngritur aktakuzën PP/I.nr. 89/2018, me dt. 12.06.2019, kundër Sh.G. për shkak të veprës penale, vrasje e rendë nga neni 179 par. 1

nen par. 1.5 të KPRK-se, dhe vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 te KPRK-se, kundër të akuzuarit I. C. për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 te KPRK-se.

Gjykata në këtë çështje penale ka vendosur me aktgjykim PKR.nr.43/19 të dt.14.10.2022 i përpiluar me dt.14.12.2022 ashtu që:

Të akuzuarin Sh.G. e ka gjykuar: për veprën e parë penale vrasje nga pakujdesia nga neni 181 te KPRK-se i ka caktuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite. Për veprën e dytë penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose ne posedim te pa autorizuar te armëve nga neni 374 par. 1 te KPRK-se i ka caktuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite. Konform nenit 80 te KPRK-se, i është shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vite e 6 (gjashtë) muaj, që do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në këtë dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 23.09.2018 e tutje. Është obliguar i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 300€ (treqind euro) në emër të paushallit gjyqësor shumen prej 200 € (dyqind euro) si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro) të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Të akuzuarit pas shpalljes së aktgjykimit i është vazhduar masa e paraburgimit.

Të akuzuarit I. C. për vepër penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose ne posedim te pa autorizuar te armëve nga neni 374 par. 1 te KPRK-se i ka caktuar dënim me gjobë në shumën prej 2.000 (dymijë euro) të cilën obligohet ta paguaj më së largu në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit. Në qoftë se i akuzuari dënimin me gjobë të cekur si më lartë nuk dëshiron apo nuk mund të paguaj në afat të caktuar, atëherë i njëjti dënim do të zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 € (njëzet) euro të gjobës. Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 250€ (dyqind e pesëdhjete euro) në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 150€ (njëqind e pesëdhjete euro) si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro) të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Konfiskohen armët B. model ... kalibër . mm, me numër serik B.. .., një karikator të të njëjtës armë dhe .. fishekë si dhe pistoleta e tipit B. .. e kalibrit . mm, më numër ..- një karikator dhe një fishekë. Të njëjtat pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të shkatërrohen. Të njëjtat gjenden në ruajtje sipas rastit policor-...-.... Të dëmtuarit I. T. dhe N. T., e dëmtuara A. C. në cilësi edhe të përfaqësueses ligjore të dy fëmijëve të saj të mitur për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi të cekur si më lartë kanë paraqitur ankesë: -Prokurori i Shteti me dt.05.01.2023 për të gjitha bazat ligjore të ankesës, përfaqësuesi i autorizuar i palëve të dëmtuara av. Berat Tmava me dt.05.01.2023 për shkak të vendimit mbi sanksionin penale dhe avokatet Erina Berisha dhe Besnik Berisha me dt.12.01.2023 për të gjitha bazat ligjore të ankesës.

Gjykata e Apelit me aktgjykim PAKR.nr.103/2023 të dt.23.03.2023 e ka aprovuar ankesën e prokurorisë dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje, ndërsa ankesat e parashtuara nga përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarve av.Berat Tmava dhe mbrojtësve të akuzuarve Sh.G., av.Besnik Berisha dhe Erina Berisha mbetën të pa shqyrtuara.

Gjykata ka caktuar rishqyrtimin gjyqësor në këtë çështje penale. Mbrojtësi i të akuzuarit Sh.G. av. Besnik Berisha është paraqitur si mbrojtës me autorizim në seancë. Trupi gjykues ka vendosur ti lejoj mbrojtjen e të akuzuarit Av. Besnik Berisha meqë çështja është anuluar dhe kthyer në rishqyrtim dhe duke pasë parasysh se nga Gjykata e Apelit nuk është trajtuar çështja e përjashtimit të avokatit Besnik Berisha nga shqyrtimi i mëparshëm edhe pse ankesa ishte e paraqitur nga ana e të njëjtit në këtë drejtim. Gjykata e apelit kishte theksuar se me aprovimin e ankesës së prokurorisë dhe sipas detyrës zyrtare anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë departamenti i krimeve të Rënda PKR.nr.43/19, ankesat e paraqitura nga përfaqësuesi Ligjor i të dëmtuarve Av. Berat Tmava dhe ankesa e përbashkët e avokatëve Erina Berisha dhe av.Besnik Beirsha mbeten të pa shqyrtuar. Pra, lejimin i mbrojtësit Besnik Berisha i autorizuar i të akuzuarit Sh.G., gjykata ka vendosur pasi çështja është anuluar do të thotë është kthyer në pikën zero dhe me qëllim të respektimit të të drejtave të akuzuarit dhe mos prolongimit të çështjes, e veçanërisht faktit se Gjykata e Apelit nuk e kishte vlerësuar këtë pretendim ankimor të mbrojtjes.

Me dt.28.09.2023, ka filluar rishqyrtimi gjyqësor pasi disa seanca paraprakisht kanë dështuar të mbahen. Në shqyrtim gjyqësorë prokurori ka lexuar aktakuzën me disa korrigjime që i ka bërë në seancën e mëparshme të shqyrtimit gjyqësor. Të akuzuarit janë njoftuar serish me të drejtat e tyre si dhe me pasojat dhe përpirësit e pranimi të fajësisë dhe të akuzuarit secili veç e veç janë deklaruar. I akuzuari Sh.G. ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës për vrasje e rëndë, ndërsa e pranon fajësinë për vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 te KPRK-se, po ashtu i akuzuari I.C. ka deklaruar se e pranon fajësinë për vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 te KPRK-se që i vihet në barrë. Seanca ka vazhduar me fjalën hyrëse dhe administrimin e provave lidhur me veprën penale që sipas aktakuzës i vihet në barrë të akuzuarit Sh.G. dhe atë vrasje e rëndë vrasje e rëndë nga neni 179 par. 1 nen par. 1.5 të KPRK-se.

-Pas dëgjimit të fjalës hyrëse rishqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me dëgjimin e dëshmitarëve dhe atë:

Në seancën e dt.08.11.2023 janë dëgjuar të dëmtuarit A.H., F.Z. dëshmitarët N.Gj., N.M., F.M..

Të njëjtit kanë deklaruar se qëndrojnë pranë deklaratave që kanë dhënë më parë në prokurori dhe polici si dhe pranë deklaratave të dhëna para gjykatës në shqyrtimin e parë gjyqësorë. Ndërsa dëshmitarja N.M. ka deklaruar se qëndroj pranë deklaratës që ka dhënë para gjykatës, ndërsa nuk qëndron pranë deklaratave të dhëna më parë në prokurori dhe polici. Se pse nuk qëndron pranë atyre deklaratave e ka cekur para gjykatës kur ka dhënë deklaratën.

Në seancën e dt.29.11.2023 është dëgjuar e dëmtuara A.C., dëshmitarët: Z.T., L.P., Sh.T., G.B., Z.B., T.M., R. M..

E dëmtuara A.C. ka deklaruar se qëndroj pranë deklaratës së dhënë para gjykatës me dt.11.12.2019 nuk ka çka të shtoj. Qëndron edhe pranë deklaratës së dhënë në prokurori me dt.08.10.2018, edhe pse kanë kaluar 5 vite ato që i ka thënë sikur herën e parë janë edhe tani, kërkon që të vendoset drejtësia dhe si familje gjejnë paqe ma anë të drejtësisë, fëmijëve të saj tu ipet mundësia të rriten të qetë pa presionin e gjakmarrjes. Kur vendoset drejtësia karshi veprës penale që e ka pa krejt Kosova edhe këta si familje është më e lehtë me gjetë paqe dhe fëmija me u drejtu në një jetë normale. Pas dëshmimeve që ka dhënë në gjykatë nga pala e akuzuar nuk ka pas mesazhe as ndonjë presion. Nga të akuzuarit ka vazhduar të marrë pagë në shumën prej 500 euro

mirëpo që dy vite të njëjtit e kanë ndal pa ndonjë arsye. Këtë e thotë për shkak të publikut sepse çdo qytetar i D. thotë se ty ta kanë siguruar jetën G. G. janë ata që ta vranë bashkëshortin ti lanë fëmijët pa babain e tyre dhe në njëfarë mënyrë të shantazuar dhe kurdo ta ndalin pagën dhe kurdo ta qesin. Këta ma kanë vra bashkëshortin, mirëpo dinjitetin nuk mund të na vrasin. Nuk ka ardhur të ju kërkoj pagë të njëjtëve sepse ajo punë ka përfunduar. Të njëjtit e kanë ditë se kjo është kujdestarja e fëmijëve dhe kjo ka të drejtë me u deklaruar se a e pranon atë pagë apo jo. Edhe pse nuk është ndërjerë mirë kur i ka pranuar sepse ka pas dëshirë ai që është vra me i marrë e jo unë.

Dëshmitarët: Z.T., L.P., Sh.T., G.B., Z.B., T.M., R. M., me rastin e dhënies së dëshmisë së tyre kanë deklaruar se qëndrojnë pranë deklaratave të tyre të dhëna më parë para gjykatës.

Në seancën e dt.11.12.2023 janë dëgjuar ekspertet: Q.T., L.R., janë dëgjuar zyrtarët policorë në cilësi të dëshmitarëve: B.T., S.L., H.D., S.S., M.S..

Ekspertet Q.T., L.R. kanë deklaruar se mbesin pranë mendimeve të dhëna më parë para gjykatës dhe pranë ekspertizës dhe plotësimin të ekspertizës. Eksperti L.R. i pyetur lidhur me armën e përdorur ditën kritik se a ka qenë në rregull ka theksuar se armët objekt Ekzaminimi gjatë qitjeve testuese apo provuese kanë qenë funksionale të cilin konstatim e kemi dhënë edhe me shkrim dhe para gjykatës. Më saktësisht lidhur me armen B. i njëjti ka theksuar se ka qenë funksionale nuk ka pas ndonjë defekt apo ngecje në operimin e pjesëve të saj.

Dëshmitarët B.T., S.L., H.D., S.S., M.S., po ashtu të njëjtit edhe në rishqyrtim kanë deklaruar se qëndrojnë pranë deklaratave të dhëna më parë para gjykatës.

Në seancën e dt.19.12.2023 gjykata ka dëgjuar dëshmitarin A.H., P.M.dhe Y.H.. Të tre këta dëshmitar kanë deklaruar se qëndrojnë pranë deklaratave të dhëna më parë në shqyrtim gjyqësorë.

Në seancën e dt.31.01.2024 është marr vendim dhe janë lexuar deklaratat e të dëmtuarve të cilët edhe pse të ftuar në mënyrë të rregullt nuk janë paraqitur në seancë dhe kanë deklaruar se nuk do të marrin pjesë në seancë dhe atë I.T., N.T., të dhëna para gjykatës me dt. 10.12.2019, si dhe në prokurori me dt. 09.10.2018. janë lexuar edhe deklaratat e dëshmitarëve të cilët nuk kanë mundur të sigurohen në bazë të ftesave të rregullta dhe as me urdhëres drejtuar policisë dhe atë: deklarata e D. T., e dhënë para gjykatës me dt. 11.12.2019, si dhe në prokurori me dt. 08.10.2018, deklarata e dëshmitarit S. T., e dhënë para gjykatës me dt. 11.12.2019, dhe në prokurori me dt. 09.10.2019, si dhe deklarata e dëshmitarit L. C., e dhënë para gjykatës me dt. 28.01.2020. Për leximin e këtyre deklaratave janë pajtuar të gjitha palët në procedurë, meqë dispozita e neni 335 par. 1 nën par. 1.3 të KPRK-së parasheh një mundësi të tillë kur të gjitha palët pajtohen për leximin e deklaratave.

Më pas janë administruar provat e tjera materiale:

- Fllesh Raport nr.....-...-..., i dt.23.09.2018
- Raport i policit H.D. i dt 23.09.2018
- Shënim zyrtar i hetuesve Xh. N. dhe H. M. me nr.....-...-..., i dt 23.09.2018.
- Raport njoftues i dt 24.09.2018, nr.....-...-...i hetuesit I. H. .
- Raport i policit hetues nga vendi i ngjarjes i dt 23.09.2018, i rreshterit R. M..
- Raport policor hetues i dt 23.09.2018, I. H.
- Raport policor hetues i dt 24.09.2018, I. H.

- Deklarata e te dyshuarit Sh.G. e dhëne ne polici me dt 23.09.2018.
- Deklarata e dëshmitarit Z. T. e dt 23.09.2018.
- Deklarata e te dëshmitarit N.Gj. e dhënë ne polici me dt 23.09.2018
- Deklarata e dëshmitarit A.H. me po te njëjtën date 23.09.2018 .
- Deklarata e dëshmitares F.M. me po te njëjtën date dhëne ne polici me dt. 23.09.2018
- Vërtetim mbi konfiskime armës e llojit B.me nr.-.-... e dt 23.09.2018,
- shikohen Foto dokumentacion i SMS-ve nga telefoni i N.M.
- Deklarata e dëshmitares N.M. e dhëne ne polici me dt 25.09.2018
- Vërtetim mbi konfiskim i dt 24.09.2018 te telefonit me nr..../...-... i te pandehurit Sh.G.
- Raport i policit hetues I. H. i dt 25.09.2018-
- Raport i policit I. H. i dt.25.09.2018-
- Lista e dëshmime e dt 23.09.2018 me nr.....-.-... i 2 telefonave te llojit 'IPHONE' i te pandehurit Sh.G. dhe Samsung i viktimës A.T. .
- Raporti i Ekzaminim të vendit te ngjarjes nga Njësia i Forenzikes se Krim Teknikes, DRP ne Peje, NR. T. ./... se bashku me Fotoalbum i dt 23.09.2018
- Raport i policit hetues I. H. i dt 01.10.2018
- Raport i policit hetues I. H. i dt 25.09.2018
- Vërtetimi mbi konfiskimin i dt 01.10.2018 i një telefoni Samsung dhe kartelës .../...-...
- Raport mjekësor për vdekje ne emër te A.T. me nr..... i dt.23.09.2018
- Raport i këqyrjes se vendit te ngjarjes i dt 23.09.2018 T. nr ./....
- lista e dëshmime e dt.24.09.2019 -mostrat e marr nga i pandehuri, pistoleta e llojit B., predhe e fishekut, gëzhoje me mbishkrim te stampuar S.
- Raporti i hetuesit i dt.04.10.2018 –I. H. #-....
- Lista e dëshmime e dt.24.09.2018 -Nje IPHONE me nr. -.....-... -... -prone e Sh.G. Telefon Samsung -.../...-...i viktimës A.T.
- Deklarata e dëshmitarit F.Z. e dt 08.10.2018 dhënë ne polici
- Deklarata e dëshmitarit L. H. e dt 08.10.2018 –dhëne polici
- Raport i ekspertizës balistike-dt 21.11.2018.me nr. .A./-.....-.....-.....
- Foto dokumentacion –për armën -leje per arme shenjëtarie -I.C.
- Raport i policit hetues i dt.30.10.2018 –I. H.
- Raport i policit hetues I. H. i dt.18.10.2018 me Foto album
- Raport i ekspertimit balistik i dt.12.11.2018. me nr. A./...-.....-.....-.....
- Raport i ekspertimit balistik i dt.07.11.2018 me nr. –A./...-..... për mbetjet te barotit).
- Raporti fillestar i incidentit i dt. 23.09.2018
- Flesh raport i dt.23.09.2018 me nr.-.-...
- Shënim zyrtar i dt.23.09.2018 me nr.-.-... -hetuesi T.M., #....

- Raport i policit hetues I.H., i dt.08.10.2018 me nr.-.-...
- shikohet Foto dokumentacioni të cilat gjenden në shkresat e lëndës
- Lista e foto dokumentacionit dhe lista e dëshmime e dt.23.09.2018, për Pistoletën me gaz B. T. një karikator i pistoletës, një fishek, një çantë për paketimin e armës, te konfiskuara nga hetuesi T.M.
- leje e veçantë e armës -I.C. me nr. DC
- Raporti i policit hetues –I. H. i dt.12.10.2018 me -nr-.-...
- Raporti i ekspertimit A./.../...-... i dt.12.11.2018
- Raport i ekspertimit i dt.07.11.2018 nga A..-./.. i dt 07.11 .2018
- Analiza e raportit te ekspertizës e dt.24.12.2018 e hetuesit I. H.
- Raporti i ekspertizës, me nr. ...-F....-... i dt.19.10.2018. e Sektorit për Fotografi, Video analizë dhe Ekzaminime te IT-se
- Lista e dëshmime e dt 23.09.2018, Një IPHONE nr.kartele ...-.-... ne emër te Sh.G.t.

- shikohet 1 CD-....-D.-..., H.-... nga Analiza e telefonave
- shikohet Foto Album i Autopsisë dhe lexohet raporti i autopsisë me nr. M.-.... i mjekësisë ligjor në emër të A.T. – departamenti i mjekëses ligjor departamenti në Prishtinë
- Deklarata dëshmitares A.C. e dt.08.10.2018 e dhënë në prokurori
- Deklarata e dëshmitarit N.Gj. e dt.09.10.2018 në prokurori
- Dëshmitarit A.H. dt.15.10.2018 , dhe dëshmitarit F.Z. dt.15.10.2018
- Deklarata e dëshmitares F. M. e dt.15.10.2018,
- Deklarata e dëshmitarit Z. T. i dt.17.12 .2018,
- Deklarata e dëshmitarit -Dr spec, Muhamet Halitaj i dt.7.12.2018,
- raporti i ekzaminimit psikiatrik nga instituti i Psikiatrisë forenzike i dt.01.03.2019 mbi gjendjen e shëndetit mendor për të pandehurin Sh.G.,
- Përgjigja në urdhëresën e prokurorisë nga departamenti traseologjisë Forenzike me nr. Reference A. – .. , i dt.11.04.2019, lidhur me veprimet e të pandehurit Sh.G. me armë për ditën kritike.
- Procesverbal mbi marrjen ne pyetje e te pandehurit Sh.G. me dt.04.12.2018, si dhe ajo e dt.02.04.2019.
- Raport i Agjencisë së Forenzike në Prishtinë i dt. 08.07.2020 me nr. Reference A. – ...
- Procesverbalet mbi intervistën e dëshmitarit P.M.dhe H.D., në Inspektoratin policor të Kosovës i dt.18.12.2018, me nr. I./D./.../..V..
- Deklarata e dëshmitarit H. C. e dhëne ne polici me dt.16.10.2018 Ref-...-....

Pas administrimit të provave materiale në të njëjtën seancë me dt.31.01.2024 është dëgjuar mbrojtja e të akuzuarit Sh.G..

Mbrojtja e të akuzuarit Sh.G.

I akuzuari ka deklaruar: -Kam deklaruar edhe herën e parë, e vërteta është vetëm ajo dhe mbetem pranë asaj që kam deklaruar, dhe jam i penduar gjithë jetën për atë që ka ndodh, nuk ka ndodh asgjë me dëshirën dhe vullnetin tim, krejt çka ka ndodh, ka ndodh pahiri tu bo hajgare, jam deklaruar edhe njëherë se krejt jetën e jepi vetëm A. me qenë gjallë. E vërteta është kjo më ndryshe s'ka me dal, unë jam këtu, çka do që vendos Gjykata. Unë jam deklaruar edhe herën e parë edhe tash jam në gjendje me deklaruar por nuk kam me shtu diçka, përveç asaj që kam fol. Në kohën kur ka ndodhë ngjarja kam qenë 18 vjeçar me dt.20.05.2018, i kam mbushur 18 vjet, ndërsa ngjarja ka ndodh në Shtator. Gjithë familjes T., bacit. J. dhe gjithë të tjerëve të ju shprehi ngushëllime por ta dinë edhe ata se unë e kam 100 herë më të rëndë se ata. Kom me jetu dhe kam me vdekë gjithmonë me A., më vjen keq për gjithçka çka ka ndodh, nuk kam bo kurgjo me dashje. Ju kisha kerku shumë falje dhe e ndaj dhimbjen me ta sikur me më pas ndodh mua. Pas udhëzimeve nga mbrojtja që tash e tutje të qëndron në heshtje, i akuzuari Sh.G. deklaroi se nuk do të deklarohem tutje, qëndrojë pranë fjalës së mbrojtësit tim.

Fjala përfundimtare e palëve në rishqyrtim gjyqësorë

Prokurori i shtetit fjalën përfundimtare e ka paraqitur me shkrim ku i njëjti ka thekuar se: Mbetet në tërësi pran aktit akuzues-aktakuzës PP.I.nr. 89/2018, datë 12.06.2019, dhe të rikonfirmuar në seancën e fillimit të rishqyrtimit gjyqësor me dt.28.09.2023, me përmirësimet e bëra, sa i përket kohës e kryerës së veprës penale që i referohet dispozitivit: duke e precizuar sipas sekuencave të xhirimit nga kamerat e sigurisë e që duhet të jetë, rreth orës 11:05, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pandryshuar dhe po ashtu përmirësoj dispozitivin që i referohet te akuzuarit I.C., e që duhet të jetë: Prej kohës së pacaktuar e deri me dt. 23.09.2018, pjesa tjetër mbetet e pandryshuar, si dhe te kualifikimi juridik duhet të jetë ... nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Gjatë seancave gjyqësore dhe ri - shqyrtimi gjyqësor të kësaj lënde penale juridike është vërtetuar pa mëdyshje se i akuzuari Sh.G. ka kryer veprat penale: vrasje e rëndë nga neni 179 par I nënpar 1.5 të KPRK -së dhe mbajtja në pronësi, kontroll posedim të pa paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK -së, dhe i akuzuari I.C., ka kryer veprën penale: mbajtja në pronësi, kontroll posedim të pa paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së. Sepse si nga provat e mbledhura në procedurën paraprake po ashtu edhe përgjatë këtij shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në dispozitivët e kësaj aktakuze dhe në kualifikimet ligjore të veprave penale ngase në veprimet e të akuzuarit Sh.G. gjenden të gjitha tiparet-elementet përbërëse të figurës se veprave penale vrasje e rëndë nga neni 179 par I nënpar 1.5 të KPRK-së dhe mbajtja në pronësi, kontroll posedim të pa paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK -së, dhe në veprimet e te akuzuarit I.C. gjenden te gjitha tiparet-elementet përbërëse të figurës se veprës penale dhe mbajtja në pronësi, kontroll posedim të pa paautorizuar të armëve nga neni 374 par. I të KPRK -së edhe atë: me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve sa i përket veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll posedim të pa paautorizuar të armëve nga neni 374 par. I të KPRK -së, e që këto pranime të fajësisë nga ana e të akuzuarve janë në përputhje të plotë me provat që i posedon Prokuroria dhe kushtet ligjore të përcaktuara në KPP si dhe provat personale si: dëshmitë e dëshmitarëve - të dëmtuarve I.T., N.T., A.C., A.H.e F.Z., dëshmitë e dëshmitarëve: D.T., S.T., F.M., N.M., N.Gj., Z. F., L.P., G.B., Sh.T., Z.B., Q.T.ekspertit i AKF-së, R. M., B.T. hetues i forenzikës, P. M., I.H. e S.L., L.R. ekspert i balistikes, S. S., H. D., M.S., dhe A. H. dhe provave materiale si: flesh raporti i policisë, raporti i policit i dt. 23.09.2018, shënim zyrtar i dt.23.09.2018, raport njoftues i dt.24.09.2018, raport i policit hetues nga vendi i ngjarje si dt.23.09.2018, raport policor i hetuesit i dt.23.09.2018 I.H. dhe i dt.24.09.2018, vërtetimi mbi konfiskimin e armës të Ilojit "B." numër-.-... e dt. 23.09.2018, 2 CD njëra nga vendi i ngjarjes si dhe një nga pamja e jashtme e objektit të kompanisë "G. A." në D., foto dokumentacioni i sms nga telefoni i N.M., vërtetim mbi konfiskim i dt. 24.09.2018 të telefonit nr.044-998-816 pronë e të pandehurit Sh.G., dy raportet e policit hetues Y.H. të dt. 25.09.2018, lista e dëshmimeve e dt. 23.09.2018 me numër-.-... i dy telefonave të Ilojit "I." i të pandehurit dhe "S." i viktimës A.T. dhe ekzaminimi i vendit të ngjarjes nga njësitë i forenzikës së krim teknikës në Pejë me numër T. ../... bashkuar me foto album, raportet e policit hetues Y.H. e dt.01.10.2018 dhe 25.09.2018, vërtetimin mbi konfiskimin e telefonit Samsung dhe kartelës me numër ...-.-... i dt. 01.10.2018, raport mjekësor mbi vdekjen në emër të A.T. me nr. i dt. 23.09.2018, raport i këqyrjes nga vendi i ngjarjes i dt. 23.09.2018 me numra T../..., mostrat e marra nga i pandehuri pistoleta e Ilojit "B.", predhë e fishekut, gëzhjojë me mbishkrim të stampuar S., raporti i hetuesit I.H. i dt. 04.102018, një Iphone-.....-.....-...pronë e Sh.G., telefon S. - ...-.-... e viktimës A.T., raporti i ekspertizës balistike i dt. 21.11.2018 A./.....-...../.....-....., foto dokumentacion - arma leje për arnë shenjëtarie e I.C., raport i policit hetuesi i dt. 30.102018 I.H., raporti i policit hetues I.H. i dt. 18.10.2018 me foto album, raport i ekspertimit balistik i dt.12.11.2018, A./.....-...../.....-....., raport balistik i ekzaminimit balistik i dt. 07.11.2018-A./..... e mbetjeve të barotit, raport fillestar i incidentit i dt. 23.09.2018 nga stacioni policor në D.me nr.-.-..., ..-.....-.....i dt. 17.10.2018 në emër të I.C., raport fillestar i incidentit i dt. 23.09.2018, flesh raport i dt. 23.09.2018-....-.-..., shënim zyrtar i dt. 23.09.2018-....-.-... i hetuesit T.M., raport i policit hetues I.H. i dt. 08.10.2018-2018-HRP-123, foto dokumentacion, lista e dëshmimeve e dt. 23.09.2018 pistoletë me gaz B.T., një karikator i pistoletës, një fishekë, një qante për paketimin e armës të mbledhura nga hetuesi T.M., leje e veçantë e armës në emër të I.C. D., raport i policit hetues I.H. i dt. 12.10.2018-nr.....-H.-..., raport i ekspertimit A...../...../...../..... i dt. 12.11.2018, raporti i ekspertimit i dt. 07.11.2018 nga A./...../.. i dt. 07.11.2018, analiza e raportit të ekspertizës e dt. 24.12.2018 e hetuesit I. H., raporti i ekspertizës me nr. ...-F.-.... i dt. 19.10.2018 e sektorit për fotografi, Video analizë dhe ekzaminim të .., lista e dëshmimeve e dt. 23.09.2018 një I. me numër kartele ...-.-... në emër të Sh.G., një

telefon samsung me nr. ...-...-... në emër të viktimës A.T., I C.-.....D.-...,H...-... nga analiza e telefonave, foto album i autopsisë, raport i autopsisë M.. -... i Mjekësisë Ligjore në emër të viktimës A.T. i lëshuar nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore në Prishtinë, raport i ekzaminimit psikiatrik i Institutit të Psikiatrisë Forenzikës e dt. 01.03.2019 mbi gjendjen e shëndetit mendor në emër të Sh.G., përgjigje në urdhëresën e prokurorisë nga AKF departamenti i traseologjisë forenzike me numër R./A./.....-... i dt. 11.04.2019 lidhur me veprimet e të pandehurit Sh. me armë ditën kritike.

Prokurori i shtetit konstaton, nga provat që i ka, të cilat janë ligjërisht të pranueshme, të mjaftueshme, të besueshme dhe bindëse për gjetjen dhe shpalljen e të akuzuarve Sh.G. dhe I.C. penalisht të përgjegjshëm (fajtorë), sepse veprimet e të akuzuarve janë të vullnetshme duke ndjekur rrugën logjike ngase nuk ka mundur të i vlerësoj si të rëndësishme përcaktuese (si fakte vendimtare) dhe ti marr në konsideratë të dhënat e tjera që do ta mund të mohojnë apo përjashtojnë veprimet e të akuzuarve si të vullnetshme dhe gjendjen mendore të tyre.

Ndërsa, gjatë caktimit dhe shqiptimit të sanksionit penal i propozojmë Gjykatës ti merr parasysh rrethanat rëndësuese edhe atë: për të akuzuarin Sh.G. të marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, vepra penale është kryer në vend publik - lokal dhe në vend të punës ku viktima ka qenë i punësuar në biznesin "G." pronë e familjes së të akuzuarit, e që kjo veprë penale ka shkaktuar shqetësim tek qytetarët e D. dhe më gjerë, viktima ka qenë familjar, prind i dy fëmijëve, ndërsa si rrethana lehtësuese të marr për bazë: pranimin e kryerjes se veprës penale: mbajtja në pronësi, kontroll posedim të pa paautorizuar të armëve nga neni 374 par. I të KPRK -së si në dispozitivin II, dhe moshën e re të akuzuarit, ndërsa në rastin e të akuzuarit I.C. të marrë parasysh si rrethana rëndësuese shkallën e përgjegjësisë penale, ndërsa si rrethana lehtësuese të marr për bazë pranimin e kryerjes se veprës penale, dhe të

njëjtëve ti shqiptojë sanksion penal të paraparë me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, i cili do t'i përgjigjet të gjitha rrethanave dhe peshës së kryerjes së veprave penale dhe me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit.

Mbrojtësi i viktimave *Luan Mehmetaj*, në fjalën e tij *përfundimtare* ka deklaruar: e përkrah fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, ndërsa fjalën përfundimtare të tij e paraqet me shkrim ku ka thksuar: Gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor kryesor të rigjykimit, sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit u vërtetua në tersi dyshimi i bazuar mirë se i akuzuari Sh.G. është penalisht përgjegjës për veprën penale, vrasje e rënd sipas nenit 179, par. 1, nënpar. 1.5 Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Në këtë çështje penale, asnjëherë nuk kishte asnjë dilemë se kush është kryerës i kësaj veprë penale. Nuk kishte asnjë dilemë se subjekti i kryerjes së kësaj veprë penale ishte i akuzuari Sh. dhe se përgjegjësia e tij penale ishte e plotë pa asnjë të metë fizike, mendore, psiko-sociale apo sociale. Pra, elementi subjektiv i përmbushjes së përgjegjësisë penale ishte i pa diskutueshëm. Po ashtu se çfarë ishte Objekt i kryerjes së kësaj veprë penale nuk kishte asnjë dyshim, për arsye se objekt i kryerjes së kësaj veprë penale ishte vrasja e A.T..

E nderuar gjykatë, kualifikimi i veprës penale sipas të drejtës penale nxjerrët prej figurës së veprës penale. Në këtë rast Kodi Penal i Kosovës e drejta penale e Kosovës, e drejta penale bash kohore, praktika gjyqësore dhe doktrina juridike në përgjithësi njeh tri forma të kryerjes së veprës penale: formën themelore (ose të rëndomtë), formën kualifikuese (ose cilësore) dhe formën e privilegjuar. Andaj bazuar në interpretimin gramatikor, sintetik, komperativ, objektiv dhe subjektiv të normave juridike-penale si dhe vërtetimin e plotë të gjendjes faktike vetëm forma e

kualifikuar ose cilësuar mund të jetë figurë e veprës penale për të cilën sot jemi këtu para trupit gjykues. Rigjykimi i kësaj çështje penale dhe Aktvendimi i Gjykatës së Apelit nxori në pah domosdoshmërinë e kuptimit të vërtetë të drejtësisë që duhet nxjerrë me rastin e gjykitimit të kësaj çështje penale.

Nëse i marrim në tërësi të gjitha provat e proceduara në këtë çështje penale do ta shohim se vetëm një element psikik i të akuzuarit të dhënë gjatë mbrojtjes së tij, e ndanë formën e kryerjes së kësaj veprë penale mes të kualifikuarës dhe privilegjuarës. Ky element psikik i cili kurrë dhe me asnjë mjet (qoftë me poligraf) nuk mund të vërtetohet është mohimi i tij se vrasja është kryer pa dashjen e tij. Asnjë arsye tjetër nuk pretendohet në mbrojtjen e tij pos “nuk e di, nuk me kujtohet dhe se krejt kjo ka ndodhe pahiri dhe kam mendu se revolja është me gaz”.

Ndërsa në anën tjetër, kjo gjykatë nuk arriti të marrë asnjë provë relevante rreth figurës së veprës penale nga dëshmia e shumë dëshmitarëve, te cilët ishin thujse në një vij me deklarime krejtësisht rrethe e rrotull. Ndërsa përjashtimisht dëshmitarja F.M. mohoi deklaratat e dhëna në procedurë paraprake me arsyetimin se kinse ato nuk janë shkruar sipas vullnetit dhe fjalëve të saja por janë shkruar si kanë dashtë ata. Kjo vërteton se dëshmitarja në gjykatë shpreh tendencën e hapur për të ndryshuar deklaratat e saja dhe se nuk ka asnjë arsye për të besuar, se policia ndryshon deklaratat sipas qejfit të tyre e jo sipas asaj çfarë deklaroi dëshmitarja. Kjo na tregon se dëshmitarja është në lidhje gjaku me të akuzuarin dhe se dëshmia e saj para gjykatës është vetëm për arsye subjektive që ti dalë në mbrojtje të akuzuarit e jo ta thotë të vërtetën. Dëshmitë e ekspertëve të balistikës të dhënë para këtij trupi gjykues e vërtetojnë se kryesi i kësaj veprë penale, ishte ekspert në përdorimin e armës dhe se prej momentit të parë të hapjes së fiokut, nxjerrjes së armës, mbushjes së saj dhe shtirjes gjithçka ishte profesionale në kuptim të përdorimit të armës. Ky mendim i ekspertëve e vërteton edhe te pavërtetën e të akuzuarit që kishte thënë gjatë mbrojtjes se ai vetëm 3 herë në jetën e tij ka shti me armë dhe atë me gaz.

Po ashtu nga dëshmia më e fuqishme, më e qartë dhe më e plotë e video-incizimit e siguruar nga vendi ngjarjes vërteton në tërësi se i akuzuari pasi ishte i rrethuar me disa persona, punëtor dhe vajzën e hallës dhe pas bisedave të shkëmbyera mes tyre, në momentin që merr telefonatën, dhe fillon të flas në telefon, pas disa sekondash punëtorët përreth ndryshojnë mimikat e fytyrës, fillojnë të lëvizin dhe të largohen nga i akuzuari për shkak se ndryshon atmosfera, i njëjti pasi që e kryen telefonatën, me një shprehje të nervozes, ku edhe i vije motivi i vrasjes, ulet në karrige, shikon anash dritares nga ana e djathtë, hapë fiokun e tavolinës, nxjerrë armën, e mbush me fishek dhe merr në shënjestër të ndjerin A.T. dhe me këtë rast rrezikon jetën edhe të dy personave tjerë që ishin afër tij. E nderuar gjykatë, gjykimi i drejtë, besimi në drejtësi, betimi para kushtetutës dhe ligjit, nderi dhe integriteti i gjykatës, mbrojtja e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, e drejta për jetë etj, nuk mund të kthehen po qese në nuk i ruajmë ato. I ndjeri nuk jeton më, atij iu privua jeta në vendin e tij të punës, nga vet pronari i tij. Ai la pas vete një grua dhe dy fëmijë, la prindër e të afërm. Ai nuk është më në mesin tonë që të na thotë asnjë fjalë, as ti përqafoj fëmijët e tij. Ai tani kërkon vetëm drejtësi.

Mbrojtësi i viktimave në kuptim të nenit 214 të KPPRK-së, paraqet kërkesën pasurore juridike ashtu siç përcaktohet me këtë nen. Në specifikacionin e kërkesës pasurore juridike në dëmin e shkaktuar janë përfshirë shpenzimet materiale dhe jo materiale dhe atë: për pagat, shpenzimet për rritjen, ushqimin, përkujdesjen, shkollimin e fëmijëve, fitimin e humbur, dëmi për shkak të humbjes së jetës së bashkëshortit, mbetja pa burrë, fëmijët pa baba, dhimbjet shpirtërore, vizitat tek psikologu, paragjykimet, dëmet shpirtërore etj. Ashtu që shuma e përgjithshme e dëmit të paraqitur është 628.000€ (gjashtëqindë e njëzet e tetë mijë euro)

Mbrojtësi i të akuzuarit *Sh.G. av. Besnik Berisha në fjalën e tij përfundimtare* ka deklaruar: tragjedia e vitit 2018, e cila goditi së paku dy familje do të mbetet një nga goditjet më të mëdha për klientin tim dhe familjen e tij, për të cilën ai në vazhdimësi ka shpreh keqardhje, pendim, ka përjetu dhimbje trishtim dhe kush do njeri me ndërjegje të pastër ka mundë ta deduktojë nga sjellja e tij, nga gjendja e tij shëndetësore dhe emocionale, si dhe nga rrethanat në qendrat e ndalimit, të paraburgimit, të trajtimit dhe jo vetëm. Sidoqoftë kjo tragjedi domosdoshmërisht duhej të përballlej me drejtësi dhe beteja për drejtësi filloi që në ditën e parë duke vazhduar deri në Mars të vitit 2021, muaj ky ku në fakt rruga për drejtësi u përball me padrejtësi, dhimbja për fëmijë e familjarë , u konvertua në lakmi dhe shifrat për kompensim e harruan rëndësinë për drejtësi. Marsi i vitit 2021, shënoi edhe një nga rastet më pa precedentë të lexuara apo të dëgjua në drejtësinë kosovare, ku si rezultat i trusnisë së laikëve dhe opinionit publik në përgjithësi, u qua në këmbë një prokurori, diktoi shkeljen e ligjit dhe premtoi se do të sjellë prova të reja për mundësi gjykimi dhe vlerësimi, duke kërkuar nga gjykata që të mos shpall të përfunduar gjykimin sepse sipas tyre kishin ndërruar prokuroren dhe kërkonin mundësi të reja për të ardh tek e vërteta.

U premtua publikisht se ata do të sillnin prova të reja, por kaluan plotë 3 vjet që kjo nuk ndodhi, jo sepse këta nuk deshën, por sepse nuk kishte, nuk kanë ekzistuar, pretendimet për vrasje me dashje ishin të trilluara, e për pasojë padrejtësia në emër të drejtësisë, cenoi lirinë dhe sigurinë e secilit nga ne , jo vetëm që është në këtë sallë, por kudo që ka nevojë për drejtësi. Prokuroria ndonëse e njohur me kufizimet ligjore, në praktikën gjyqësore dhe mbi të gjitha e njohur me faktin se kishin ndryshuar aktakuzën, pas një procesi të gjatë, me mundësi të barabarta për secilin, edhe me prova që kërkonin vetëm shikimin e pastër, prapë se prapë kundërligjshëm, në mënyrë arbitrare, për të shuar kritikën e dështimeve dekadëshe në rastet e tjera, pa asnjë justifikim ligjor, e asnjë provë të re, kërkuar të ktheheshin në aktakuzën e vjetër, duke shpresuar se kështu e detyrojnë gjykatën për padrejtësi, për çka këta “aspironin” për drejtësi. Padrejtësia tjetër u manifestua thellësisht edhe në gjykatën e shkallës së dytë, të cilët me një aktgjykim që profesionistët do ta quanin “shkarravinë”, pa mbështetje me logjikë të shëndoshë juridike, pa arsyetim ligjor, e pa rekomandim se çfarë duhet të bëhet në rigjykim, anuluan aktgjykimin me pranim fajësie, për shkak të “ sipas tyre mungesës së precizimit të dashjes në dispozitiv”, ky nivel gjykimi për një aktgjykim me pranim fajësie, për një vrasje të cilësuar nga pakujdesia, është për keqardhje sikur të merrej nga një student i vitit të parë të juridikut, e jo nga një gjykatë e faktit, ligjërisht “më e mençur” se gjykata e shkallës së parë, e cila vendos jo vetëm drejtësi, por edhe standard.

Për secilin pretendim të prokurorisë të mbrojtësit të viktimave dhe vendimeve paraprahe nga Marsi e këndeje, u përgjigjemi me vendimin e gjykatë supreme në çështjen Pml.nr. 58/22, ku fatkeqësia e klientit tim Sh.G., siç duket e gjen vetën në këtë aktgjykim katër faqesh, e ku Gjykata Supreme ka konstatuar dhe korrigjuar gabimet e dy gjykatave më herët, se aktakuza kundër të pandehurit pas shqyrtimit fillestar mund të ndryshohet vetëm njëherë dhe vetëm në dobi të tij. Në asnjë rrethanë tjetër, në asnjë regjim, për asnjë dështim nuk mund të ndryshohet aktakuza sërish pa prova të dala në gjykim dhe një veprim i tillë për bindjen tonë përbën krim, për çka ata e quajnë të kundërligjshëm. Gjykata Supreme poashtu ka gjykuar se neni 359 i KPP-së, nuk i jep të drejtë gjykatës që të rihap shqyrtimin gjyqësor në rastet kur bëhet pranimi i fajësisë dhe për pranim është pajtuar edhe prokuroria që ka përfaqësuar aktakuzën. Do të lejohej sipas gjykatës rihapja po që se do të kishte nevojë për të sqaruar ndonjë fakt për të cilin paraqiten nevoja për të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Në rastin G., rihapja e shqyrtimit gjyqësor është bërë në shkelje të nenit 359, sepse është bërë me kërkesë të prokurorisë, kërkesë për të mos e mbyllur sipas tyre gjykimin me mundësi propozimit të provave të reja, por asnjëherë nuk na treguan se çfarë ndodhi me ndryshimin e dt.16 Mars, se a ishte ndryshimi i aktakuzës zyrtar apo privat, a ishte prokurori që bëri ndryshimin prokuror shteti, kompetent për çështjen, prokurori që ndoqi gjykimin dhe në vazhdimësi kërkoi nga të dëmtuarit që të ofrojnë provat dhe faktet për ta mbështetur aktakuzën mbi trillime e insinuata. A është edhe sot e kësaj dite ky prokuror shteti në detyrën e njëjtë, në departamentin e njëjtë, me kompetencën e njëjtë, apo ishte dita e fundit e tij, ajo çfarë ndodhi në këtë gjykim. Përgjigjen të gjithë e dim, për ta mbuluar dështimin kudo, kërkuan ndryshimin këtu. Por megjithatë, siç me të drejtë ka konstatuar kjo gjykatë me aktgjykimin e anuluar kundërligjshëm e padrejtësisht, prokuroria ka dështuar bashkë me përf. e palës së dëmtuar që të ofronin prova që justifikonin për keqësimin e statusit të akuzuarit, madje gjykata qartë ka bërë referencë me nenin 252 , duke e përkujtuar se gjykata nuk ka autorizim që të lejojë më shumë se sa një ndryshim, sidomos kur ajo ndodh në dëm të personit që është në gjykim.

Si pasojë e padrejtësisë nga Marsi e tutje, rasti G., përkatësisht Sh.G. është i akuzuari i vetëm në sistemin e drejtësisë së Kosovës para dhe gjatë luftës që për vrasjen nga pakujdesia dhe përdorim të armës 3 sekondash, është nën masën e paraburgim plot 5 vjet e gjysmë, pa çka se dënimi maksimal për vrasje nga pakujdesia, pa pranim fajësie dhe pa rrethana lehtësuese është 5 vite. Sot edhe nga këto shprehim keqardhjen më të thellë për humbjen e familjes T., humbje kjo që do të jetë një grupë e pambuluar ndonjëherë në kujtesën dhe shpirtin e klientit tim, por pavarësisht humbjes që ka tronditur të gjithë, padrejtësia nuk mund dhe nuk duhet ta godet askënd. Sh.G., është deklaruar fajtor për veprën penale që në ditën e parë të rikualifikimit, nuk ka qenë i dënuar asnjëherë më parë për veprë penale të ngjashme apo të njëjtë, mosha e tij e re, lidhja e ngushtë me tani të ndjerin, lidhje kjo që provohet për ata që kanë sy e vesh, në video incizimet të dala tashmë në shesh, festa që e shoqëroi ditën tragjike, për shkak se siç e dini Sh.it atë ditë i ishte premtuar fejesa, e solli edhe momentin tragjik për që do të duhej të merrej si rrethanë lehtësuese e jo si vrasje brenda lokalit që ka trondit D.. Vrasja e A.T., nuk e ka trondit D. për shkak se ka ndodh në lokal, e ka trondit secilin njeri normal, për shkak se ka ndodh nga pakujdesia, për shkak se ka pas 29 vite jetë, për shkak se ka lënë dy fëmijë pas vetës , një bashkëshorte dhe prindërit e tij, për shkak se ka lënë qindra kolegë që edhe sot u mungon dhe e përkujton, si dhe për shkak se pavarësisht se çka ndodh me vendimin në gjykatë, jeta e tij është e pakthyeshme, humbja e familjes e pa kompensueshme dhe kjo nuk është brengë vetëm e atyre që ndjekin akuzën.

Më duhet ta përkujtojë mbrojtjen e Sh. në Mars të vitit 2021, dridhjet dhe dënësat e tij, më duhet tua sjell kujtesën në polici kur ai qante dhe dëneste vetëm që e dinte se A. ishte i plagosur, me pamje të kamerave të sigurisë ku ai shtangohej, kap kokën me duar, fton tjerët për ta thirr mixhën I., i lutet këtij të fundit për ta çuar A. jashtë shtetit, për t'ia shpëtuar jetën, sepse ai nuk kishte dijeni se ai ishte momenti i fundit të tij. Kushdo që i ka pa këto pamje dhe i ka përjetuar si njeri, me mendje të shëndoshë do të konkludonte se kemi të bëjmë me një vrasje të kryer nga pakujdesia. Për këtë është Sh.G., fajtor, për këtë është deklaruar fajtor, për këtë e ka vuajt dënimin maksimal nën masën e paraburgimit dhe vetëm për këtë një ditë, herët a vonë do të mund të qëndrojë një aktgjykim i drejtë dhe i ligjshëm. Siç e dini me vite të tëra nuk është ushtruar ankesë për ndërprerjen e masës së paraburgimit, jo sepse masa ishte e nevojshme, por për shkak se ishte Sh.i ai që insistonte që vuajtjen e tij për atë tragjedi ta kalonte i mbyllur brenda 4 mureve, së paku 22 orë, brenda 24 orëve, i ndërgjegjshëm se fati i tij tragjik atë ditë dënohet me ligj dhe ky duhet ta vuajë dënimin.

Meqenëse tashmë është vuajtur maksimumi i ligjshëm, janë vuajtur edhe 6 muaj së paku përtej maksimumin, kërkesa e drejtë e ligjshme do të ishte që paraburgimi të ndërpritej me rastin e shpalljes së aktgjykimit, sepse çdo zgjatje e mëtutjeshme do të kalonte qëllimin, rëndësinë dhe nevojën e një mase të tillë dhe do të ishte një dënim i paligjshëm. Pranimi i fajësisë që në ditën e parë është edhe për përdorimin e armës për të cilën dispononte leje axha i tij dhe dënimi për këtë pikë të aktakuzës, nuk mund dhe nuk do të duhej të ishte si masë balancimi për tu rrit dënimi i asaj çfarë ligji e ka kufizuar me 5 vite. Gjykatës me respekt i përkujtojmë se historikisht se në këto 24 vite së paku drejtësi të konsoliduar në Kosovë askush dhe asnjëherë nuk është dënuar për përdorim sekondash të armës, në rrethana ekskluzivisht festive siç ndodhi 23.09.2018, për këto arsye, meqenëse edhe në këtë stad kemi pranim fajësie të pandryshuar që nga Marsi i vitit 2021, ndërkaq për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, përdorim të paautorizuar, deklarim fajtor që në shqyrtimin fillestar, meqenëse nuk do të ketë seancë për shqiptimin e dënimit, gjykatës me respekt i lutemi që ti merr për bazë këto rrethana posaçërisht lehtësuese dhe dënimi unik për Sh.G., të reflektojë me atë tashmë çfarë konsoliduar në praktikë dhe me atë çka është vuajtur nga Sh.i nën masën e paraburgimit. Në fund e përsërisim keqardhje e përcjell nga ana e Sh.it dhe familjes së tij, solidarizimin me humbjen dhe pendimin e Sh.it për atë se çfarë ka ndodh. Ndërkaq sa i përket kërkesës pasurore në rast se kryefamiljari I.T., shoqëruar edhe me konfirmimin e bashkëshortes së tani të ndjerit dhe fëmijëve të tij, dhe nëse ata besojnë në drejtësi dhe janë bindur se kjo vrasje tashmë është kryer në pakujdesi, unë pa u konsultuar me klientin tim, e konfirmoj që tani se e njëjta do të ekzekutohet sapo të ri konfirmohen faktet e saktësisë së kërkesës, e pohimit dhe konfirmimit nga të dëmtuarit se ata i besojnë drejtësisë dhe janë bindur se vrasja ishte kryer në pakujdesi e jo me dashje e djallëzi, për motive të shpifura, të ulëta, e me qëllim njollosjeve jo vetëm të gjallëve, por edhe tani të ndjerit.

Në fund A.T., ishte pjesë i familjes G., ishte anëtar i devotshëm në biznesin të suksesshëm në rrafshin e Dukagjinit dhe jo vetëm, një person me vlera të larta morale, pa çka se provuan ta njollosin, një profesionist në fushën, në shërbëtor i zellshëm i klientëve të tij që i mungon biznesit sot e tërë jetën, të gjithë miqve krejt kolegëve poashtu. Nganjëherë e përdori një thënie që “le të vendoset drejtësia edhe nëse qielli përmbysset”. Po ju lusim që të vendosni drejtësi, të zhveshëni tërësisht nga historiku real apo i shpikur, hatër mbetje apo hidhërim, për shkak se ajo që e ka godit Sh.in mund ta godiste këdo, kurdo, secilin nga ne dhe nga ju, bashkë me dhimbjen dhe vuajtjen do të kërkonte, e meritonte drejtësi. Sh.G. meriton drejtësi dhe jo drejtësi të face book-ut, drejtësi të sponsorizuar e të kamufluar, drejtësi nga një prokurori e dështuar, drejtësi nga një gjykatë që kur peshon faktet dhe vlerëson provat lidh sytë dhe nuk lexon emrat por gjykon faktin kriminal. Ndërgjegjja e juaj sot është ajo që duhet ta udhëzojë në vendimmarrje, betimi i dhënë për të gjykuar drejtë në përputhje me ligjin dhe kushtetutën dhe duhet të jetë e vetmja pasqyrë që mbani para vetës në këtë rast. Kjo pasqyrë do të reflektojë se Sh.G. këtë vrasje nga pakujdesia dhe për këtë tragjedi dhe krim të kryer pa dashje ka vuajtur shumë sesa ka merituar dhe sa ligji i ka rezervuar.

I akuzuari *Sh.G. në fjalën e tij përfundimtare* ka deklaruar: nuk kam diçka për të shtuar e mbështes fjalën e mbrojtësit tim.

Mbrojtësi i të akuzuarit *I. C. av. Veton Berisha në fjalën e tij përfundimtare* ka deklaruar: pranimi i fajësisë i shprehur nga z. C., gjatë këtij rigjykimi, sikurse edhe në gjykimin e kaluar nuk është bërë sipërfaqësisht, e me qëllim të përfitimit të privilegjeve të këtij instituti, por reflekton pendimin e tij të sinqertë për faktin se ai ka rënë në kundërshtim me ligjin. I mbrojturi im nuk ishte i informuar se për posedimin e armës me gaz, duhet të ishte i pajisur me leje të veçantë të organeve kompetente, ngase po të kishte të njohur këtë fakt sigurisht do ta siguronte lejen. Meqenëse z. C. e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet kërkoj nga gjykata

që kjo rrethanë të vlerësohet si rrethanë posaçërisht lehtësuese dhe ndaj tij ti shqiptohet një dënim që në harmoni me politikën ndëshkimore dhe praktikën gjyqësore e cila është aplikuar në rastet e tjera ndaj të akuzuarve për veprën e njëjtë penale. Ekzistojnë një mori rrethanave lehtësuese që ju si trup gjykues duhet pas parasysh me rastin e vlerësimit dhe vendosjes për shqiptimin e llojit dhe lartësisë së sanksionit penal, e ato janë: shprehja e keqardhjes, koha e kaluar nga kryerja e veprës penale dhe sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale. Në mungesë të rrethanave rënduese, gjykatës i kërkojmë që konform nenit 71 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ndaj z. C. t'i shqiptojë një sanksion penal më të butë, sepse edhe me këtë sanksion penal do të arrihet qëllimi i paraparë në Kodin Penal.

I akuzuari I.C. deklaron se e përkrahë fjalën e mbrojtësit të tij dhe se derisa sa është ngritur aktakuza nuk e ka ditë se mbajtja e armës me gazë përbën vepër penale.

Duke pas parasysh deklarimin e mbrojtësit të të pandehurit I.C., si dhe marr parasysh faktin se i akuzuari I.C. e ka pranuar fajësinë në fillim të rishqyrtimit gjyqësorë dhe se vetë i akuzuari I.C. deklaron se e kam pranuar vullnetarisht, por vetëm me rastin e ngritjes e ka kuptuar se mbajtja e armës me gaz, është vepër penale dhe këtë e kam pranuar. Trupi gjykues e ka revokuar pranimin e fajësisë së të akuzuarit I.C. dhe ka vazhduar me seancën dhe është rikthyer në procedurën e provave, meqë edhe pse shumica e provave të administruara kanë qenë në lidhmëni edhe me të akuzuarin I. por disa nga provat që duhej të administroheshin për të akuzuarit I. C., pasi nuk janë administruar për shkak të pranimin të fajësisë dhe as nuk ishte dëgjuar mbrojtja e të akuzuarit e tij.

Në seancën e dt.12.03.2024, janë administruar këto prova materiale: shikohet fotografia e armës me gaz, lexohet deklarata e të pandehurit I. C. dhënë në prokurori me dt. 14.12.2018 dhe në polici me dt. 16.10.2018 dhe është dëgjuar mbrojtja e të akuzuarit I.C. .

I akuzuari I.C. në mbrojtjen e tij ka deklaruar

I akuzuari në mbrojtjen e tij thekson se ka dhënë deklaratë në polici dhe prokurori dhe qëndroj pranë atyre deklaratave që kam dhënë.

Në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka qenë në dijeni se arma e gaz përbën vepër penale, në momentin që e kam dhënë deklaratën e parë në polici e kam kuptuar. E ndiej vetën fajtor, qysh në fillim e kam pranuar fajësinë, atëherë tash edhe çdoherë e pranoj fajësinë. Sikur ta kisha dit që është vepër penale, unë e ka pa të drejtën me apliku për leje, sepse unë vetëm kam pas leje për një armë tjetër dhe ligjërisht, kur e ke një leje, keni të drejtë me apliku për 5 armë me atë leje dhe nuk kisha ra në kundërshtim me ligjin. Momentin që e kam kuptu, e kam ndier vetën keq . Edhe atëherë edhe sot e pranoj fajësinë qysh më ngarkon akuza. Mbrojtësi i të akuzuarit e këshillon të njëjtin që tani e tutje të mbrohet në heshtje. Për çka edhe i akuzuari I.C., deklaron se do të qëndrojë në heshtje.

Në seancën e dt.12.03.2024 të gjitha palëve u është dhënë mundësia e deklarimit nëse kanë diçka për të shtuar në fjalën përfundimtare.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare shton se: fillimisht e revokoj fjalën përfundimtare sa i përket I.C., të dhënë me dt.07.03.2024, ndërsa pjesa tjetër sa i përket të akuzuarit Sh.G., mbetet në tërësi ashtu siç e ka deklaruar me dt.07.03.2024, ndërsa për të akuzuarin I.C., në fjalën time përfundimtare deklaroj se mbetem në tërësi pranë aktakuzës PP/I.89/2018, të

dt.12.06.2019, të ri konfirmuar në seancën për fillimin e rishqyrtimit gjyqësor të dt.28.09.2023, me përmirësimet dhe precizitet sa i përket dispozitivit që i vihet në barrë të pandehurit I.C. dhe konstatoj që nga provat që janë administruar përgjatë këtij procesi gjyqësor, si ato materiale, ashtu edhe ato personale është vërtetuar pa mëdyshje se i akuzuari I.C., e ka kryer veprën penale që i vë në barrë. Andaj i propozon gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ti shqiptojë një dënim meritor, konform dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, po ashtu kësaj Gjykate i propozon që gjatë caktimit dhe shqiptimit të sanksionit penal ti merr parasysh rrethanat rënduese dhe ato lehtësuese, ndërsa prokuroria i propozon kësaj Gjykate që si rrethanë rënduese të ketë parasysh rrezikshmërinë shoqërore të kësaj veprë penale, e cila kohëve të fundit ka marr përmasa tejet shqetësuese në shtetin tonë, pastaj, vendi ku është gjet, apo ku është mbajtur kjo armë, në një vend publik ku kanë mundur të kenë çasje shumë qytetarë, ndërsa rrethana lehtësuese prokuroria në rastin e të akuzuarit I.C., nuk ka gjet.

Mbrojtësi i viktimave Luan Mehmetaj, shton se: mbrojtësi i të akuzuarit Sh.G., av. Besnik Berisha, gjatë fjalës së tij përfundimtare të dt.07.03.2024, e bëri një konstatim shumë të ulët për palën e dëmtuar dhe njëkohësisht e konstatoi një të pavërtetë të madhe në mesin e shumë e të pavërtetave që ai din ti thotë në fjalët e tij. Në fjalën time përfundimtare fillimisht e përkraha në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit dhe pastaj e elaborova fjalën time përfundimtare 3 faqe që kishin të bënin me veprën penale, përgjegjësinë penale, kryerësin e veprës penale provat materiale dhe personale, duke kërkuar në fund që i akuzuari të shpallet fajtor për veprën penale vrasje e rëndë, nga neni 179 par.1, nënpar.1.5, të KPRK-së, ashtu siç e ngarkon aktakuza. Më pastaj elaborova kërkesën pasurore juridike sipas Kodit të Procedurës Penale ku edhe deklarova dëmin, mirëpo avokati i të akuzuarit, sipas metodologjisë së tij poshtërues shtrembëroj qëllimisht kërkesën pasurore juridike me konstatime poshtëruese citoj “nëse kjo kërkesë pasurore juridike është me pëlqimin e palës së dëmtuar A.C. dhe prindërve të A., dhe nëse ata pajtohen dhe e pranojnë se vrasja është kryer nga pakujdesia, atëherë unë pa u këshilluar fare me klientin tim, deklaroj se do ta bëjmë kompensimin e dëmit” dua tia kujtojë av. Besnik Berisha, palëve të dëmtuara, mediave dhe opinionit të gjerë se unë gjatë gjithë këtij shqyrtimi gjyqësor kam përfaqësuar vetëm të dëmtuarën A.C., ndërsa prindërit e të ndjerit e kanë përf. e tyre të autorizuar, dhe për asnjë moment nuk kam folur dhe nuk flas në emër të tyre.

Ua rikujtojë se kurrë asnjëherë dhe për asnjë çmim as familja C. dhe as Familja T., nuk do ta shitb-lenin drejtësinë e burrit, përkatësisht e djalit të tyre, siç pretendon mendja atipike e av. Berisha, përkundrazi ata duan drejtësi dhe janë të bindur thellë se vrasja është e rëndë, ashtu siç përcaktohet në aktakuzë. Po ashtu dua të theksojë për të gjithë se vepra penale përgjegjësia penale, kryesi i veprës penale, fajësia e ndonjëherë edhe dënimi nuk kanë asnjë lidhje me kërkesën pasurore juridike, pra kërkesa pasurore juridike është institut i paraparë në KPP-së dhe për asnjë moment kjo kërkesë nuk e determinon as veprën penale, as cilësimin juridik të veprës penale dhe as dënimin, andaj lidhja që i bëri av. Berisha me kërkesën pasurore juridike, tregoj se këta janë në gjendje ta vejnë në pazare me drejtësinë, të fusin përçarje në familje, të krijojnë opinione të ulta në mesin e shoqërisë, sa që të mendojnë se vrasja e A.T., u ble apo u shit me pare, kjo është sjellje përtej viktimizimit, është ri viktimizim për palët e dëmtuara dhe sjell pasoja akoma më të mëdha për gjendjen e tyre shpirtërore dhe emocionale. Gjatë fjalës përfundimtare të av. Besnik Berisha, shpeshherë kisha përshtypjen se jam ulur në bankën e gabuar, se janë nderuar vendet në Gjykatë dhe se i akuzuari është dashur të jetë në bankën e të dëmtuarit. Pra kjo është kamuflazh e keqardhjes që shpreh mbrojtja e të akuzuarit, është pasqyra që e shohin vetën herë në njërin anë e herë në tjetrën duke harruar se një djalë i ri, në lulen e rinisë u vra në vendin e tij të punës nga pronari i tij. Për ta shtuar akoma më shumë saktësinë time, unë në seancën e dëgjimit të dëmtuarës A.C., në cilësi të dëshmitares në fund të seancës kam deklaruar:

“ prej këtij momenti pala e dëmtuar të cilën unë e përfaqësojë , nuk pranon asnjë lloj kompensimi apo ndërmjetësimi të çfarëdo lloji përmes rrugëve jo ligjore dhe se kërkesën tonë pasurore juridike do ta parashtrijmë sipas KPP-së”. Meqë kjo ka krijuar edhe një gjendje të re emocionale përmes shtrembërimeve dhe kërkon nga gjykata që të merr për bazë deklarin e palës së dëmtuar A.C., përmes letrës që ka dërguar në Gjykatë lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Mbrojtësi i viktimave deklaron: unë jam mbrojtësi i viktimave dhe vi nga zyra për mbrojtje të viktimave, nuk jam përfaqësues i autorizuar i të dëmtuarës A., nuk marr autorizime nëpërmes sms-ve nuk ka asnjë mundësi ligjore profesionale etike mbikëqyrëse etj, të zyrës sonë që ne të parashtrijmë kërkesa pasurore juridike pa pëlqimin e palës së dëmtuar. E dëmtuara ka qenë në njohuri, ka ardhur me ftesën tonë në zyrë, ku kam qenë unë dhe shefi i zyrës, ku i kemi kërkuar edhe raporte mjekësore tek psikologu dhe psikiatri, e njëjta ka thënë se do ti dërgojë, pra kërkesa pasurore juridike i është sqaruar në tërësi të dëmtuarës A.C., konform KPP-së, sepse e njëjta bëhet sipas këtij kodi , duke e specifikuar dëmin.

E dëmtuara A.C., deklaron: se ndihem tmerrësisht keq në pozicionin që gjendem sot, pa vullnetin tim, sepse gjithmonë kam deklaruar dhe vazhdojë të mbes pranë deklarinimit se për mua, për fëmijët dhe në tërësi në familjen e gjerë të A., e rëndësishme është drejtësia. Sa i përket çështjes së kompensimit që mendoj se ka ndodh një gabim i madh, se e rëndësishme për ne të vendoset drejtësia, të mbyllet çështja penale, pastaj nëse e vlerësojmë si të nevojshme të arsyeshme, unë së bashku me familjen time dhe njerëzit që mu kanë qëndruar pranë gjatë këtyre 5 viteve, atëherë do ti drejtohem gjykatës në çështje civile, gjithmonë z. Luan, e kam autorizuar që të bëjë kërkesë dhe të mos heq dorë nga e drejta legjitime që më takon si e dëmtuar por jo të bëjë specifikime ose përlllogaritje siç janë bërë në seancën e kaluar, e që tek unë dhe familja ime dhe njerëzit që më njohin kanë ndikuar keq. Për hir të opinionit publik, në qofte se e kisha pikësynim dobinë pasurore atëherë nuk isha ardh qe 5 vite për tu zvarritur në salla të gjykimeve për të pritur drejtësinë. Luteni që kërkesën e parashtruar nga z. Luan , të mos merret si kërkesë e familjes së ngushtë që i bie fëmijët dhe unë. Do ta vlerësojnë nëse kërkesën pasurore juridike do ta parashtrijë në kontest civil.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh.G., av. Besnik Berisha, lidhur kërkesën e parashtruar nga mbrojtësi i viktimave për kompensim dëmi deklaron se: të pavërtetat dolën në shesh dhe autori i tyre u demaskua keq, bashkë me dëshirën e tij, për të bërë “mrekulli”, duke lexuar të shkruarat nga të tjerët e jo nga familja e A., më duhet vetëm ta rikapitulojë se të pavërtetat që na u servuan së paku dy herë, u shoqëruan edhe me keq citimet e deklarinimit tim, por kjo nuk më habit sepse po bëhen për ta mbuluar një dështim, dhe jo për ta pasqyruar një realitet. Zyra për mbrojtjen e viktimave nuk është përmbarues i vendimeve dhe kërkesave, por mbron interesat e viktimave dhe nuk mund të parashtrijë kërkesë në shumë astronomike sepse ato mjete nuk mund të inkasohet eventualisht në llogarinë e tyre, por janë shumë që i atribuon Gjykata të dëmtuarve. Siç duket përulja dhe njollosja e imazhit të familjes T. dhe C. dhe tani të ndjerit, paska qenë e orkestruar. Përfundimisht keqardhje ishte, është dhe mbetet reale, ndërkaq kamuflimi i interesave personale rezulton të ketë adresë, në zyrën ngjitur me prokurorin e shtetit në Pejë.

I akuzuari Sh.G., deklaron se e përkrah fjalën e mbrojtësit tim.

Mbrojtësi i të akuzuarit I. C. av. Veton Berisha në fjalën përfundimtare deklaron: mbetem në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë në seancën e dt. 07.03.2024, nuk kam diçka për të shtuar.

I akuzuari I.C. ne fjalën përfundimtare deklaron: nuk kam diçka për të shtuar.

* * *

Në rastin konkrete gjykata ka analizuar ka analizuar provat e administruar në rishqyrtim gjyqësor duke marrë për bazë dispozitat e Kodit të Procedurës penale dhe ka gjetur se i akuzuari Sh.G., duhet të shpallet fajtor për vepër penale të vrasjes nga pakujdesia konform neni 181 të KPRK-se, (pra merr për bazë rikualifikimin e veprës nga prokuroria në favor të akuzuarit me dt.16.03.2021), dhe vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së. Ndërsa i akuzuari I.C. gjykata ka vlerësuar se në veprimet e tij janë përmbushur elementet e veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së. I njëjti këtë vepër e ka pranuar, do të thotë se armen në fjalë e ka mbajtur, mirëpo ka theksuar se ka menduar se nuk ka nevojë të merret leja.

Fakte të pakontestuar:

Gjatë rishqyrtimit gjyqësor dhe as më parë nuk u kontestua se i akuzuari Sh.G., me datën 23.09.2018 rreth orës 11:05 sec në D. në rr. “ L. H. “në kompaninë G. A.” e ka privuar nga jeta tani te ndjerin A. T. nga fshati Ll. Komuna e D..

Nuk u kontestua se i akuzuari Sh. pasi pranon një telefonat ku bisedon përreth..... posa e përfundon këtë bisedë e lëshon telefonin në tavolinë nga karrika ne skajin e majte te banakut ku ishte ulur, kalon në karrigen tjetër që gjendet në mes të banaku lakohet dhe nxjerr nga sirtari i tretë i anës së djathtë revolen e llojit B. Model, e vendos karikatorin ne armë shkrep në drejtim të viktimës dhe të dëmtuarve A.H., A.T. dhe F.Z., të cilët kanë qenë në një distancë 70 cm në mes vete, ndërsa në raport me të akuzuarin distanca ka qenë 4 - 5 metra dhe nga kjo shkrepje e godet tani te ndjerin A.T. në mollëzën e djathtë të fytyrës, pas këtij veprim i njëjti e kthen armën ku e ka marrë, përkundër përpjekje për ti dhënë ndihmën A.T. nuk ka mundur ti mbijetoi plagës.

Nuk u kontestuar se i akuzuari Sh.G. me dt.23. 09.2018, rreth orës 11:04 min, në D. në rrugën “ L. H. “ nr., në Kompanin G. A., në kundërshtim me Ligjin për armët ka mbajtur në posedim armën dhe atë revolen e tipit B., model, kalibër . mm, me numër serik B....., një karikator te të njëjtës armë dhe .. fishekë në atë mënyre që me rastin e kontrollit nga policia në sirtarët nën banakun e kasës qe gjendeshin në krahun e djathtë është gjetur dhe sekuestruar arma në fjalë për të cilën është konstatuar se i pandehurit nuk ka leje të Organeve kompetente.

Nuk ishte kontestues se i akuzuari I. C. më parë e gjer me dt. 23.09.2018 rreth orës 14:50 min në D., në shitoren G. A. ka mbajtur në pronësi armë më shkelje të Ligjit të zbatueshëm lidhur më armët dhe atë: pistoletën me gas e tipit B... .. e kalibrit .. mm, ..-....., një karikator dhe një fishekë në atë mënyrë qe me rastin e kontrollit nga policia në sirtarët nën banaku e kasës që gjendeshin në krahun e djathtë është gjetur dhe sekuestruar arma në fjalë për të cilën është konstatuar se i njëjti nuk ka leje të Organeve kompetente.

Fakte të kontestuara

Dashja e të akuzuarit Sh.G. për të kryer vepër penale të vrasjes së rëndë neni 179 par.1 nen par. 1.5 të KPRK-se, si dhe rikualifikimi i bërë nga ana e prokurorisë dhe më pas mbetja pranë

aktakuzës për veprë penale të vrasjes së rëndë. Me pretendim se kjo veprë penale është nga pakujdesia.

Dashja dhe dijëni e të akuzuarit I.C. se për mbajtjen e armës me gazë duhet marrë leje nga organet kompetente. Ku i njëjti deklaroi se e pranon fajësinë me pretendimin se nuk e ka ditë se për armën me duhet të merret leje.

Vlerësimi i gjykatës lidhur me veprimet procedurale

Prokurori ka ngritë aktakuzë PP/I.nr. 89/2018 të dt. 12.06.2019, kundër Sh.G. për shkak të veprës penale, vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 nën par. 1.5 të KPRK-se dhe veprë penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-se, kundër të akuzuarit I. C. për shkak të veprës penale, mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-se.

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor dhe pas administrimit të provave të propozuara në aktakuzë dhe provave tjera në shqyrtim gjyqësor prokurori i shtetit nga prokuroria Themelore në Gjilan Agron Uka me dt.16.03.2021 me rastin e dhënies së fjalës përfundimtare kishte bërë rikualifikimin e veprës penale ndaj të akuzuarit Sh.G. nga vrasja e rëndë nga neni 179 par 1 nën par. 1.5 të KPRK-se, në veprën penale vrasje nga pakujdesia nga neni 181 të KPRK-se, gjykata kishte pranuar fajësinë të akuzuarit Sh.G. dhe kishte përfunduar shqyrtimin gjyqësor.

Me dt.19.03.2021 gjykata nuk e ka shpallur aktgjykimin mirëpo ka bërë rihapjen e shqyrtimit gjyqësor konform neni 359 par 1 të KPRK-se, si dhe konform nenit 247 par 4 lidhur me nenin 248 dhe 326 të KPRK-se, kishte revokuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi që kishte vërejtur se me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit Gjykata nuk kishte cekë se pranimi i fajësisë ishte i mbështetur në provat për të cilat është ri kualifikuar. Kjo për shkak se prokuroria me rastin e rikualifikimit të veprës penale nuk kishte sjellë aktakuzën e përpiluar dhe provat në të cilat mbështetej. Prokuroria kishte paraqitur vetëm dispozivin e parë të aktakuzës dhe kishte vazhduar me fjalën përfundimtare.

Trupi gjykues me rastin e pranimit të fajësisë nuk kishte konstatuar se nëse pranimi i fajësisë kishte mbështetje në provat që gjendeshin në shkresat e lëndës, gjë që rrjedhe nga procesverbali i dt. 16.03.2021. Me këtë rast gjykata kishte konstatuar se kishte edhe mos përputhje nga dispozitivat e aktakuzës pasi që sipas dispozitivit përshkrimi faktit të dispozitivit të parë të rikualifikuar nga prokurori Agron Uka rezultonte se arma me gaz kishte qenë aty edhe para orës 14:00/h, e që sipas përshkrimi faktik të dispozitivit të aktakuzës si në piken III që i vihet në barrë të akuzuarit I. C. specifikon kohën kur është mbajtur dhe gjete nga organet policore në sirtarin apo fioken ku ishte gjendur, si dhe mospërputhje të tjera.

Gjykata duke i pas parasysh të lartcekurat e ka vendosur që të rihap shqyrtimit gjyqësor dhe me këtë rast kishte kërkesë edhe nga Prokuroria Themelore në Gjilan që të rihapet seanca, e paraprakisht në këtë rast kishte kërkesë edhe nga prokurori i shtetit që në këtë rast të ndërrohet prokurori dhe me qëllim të zhvillimit efikas të procedurës dhe zhvillimit dhe heqjes së mëdyshjeve rreth mundësisë së shkeljes së paanshmërisë dhe profesionalizmit të shtyhet seanca ku dhe do të propozojnë prova të reja, dhe të ju jepet mundësia e rishikimit dhe ri cilësimit juridike të bërë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt. 16.03.2021. Kjo parashtresë është dorëzuar në gjykatë me dt. 18.03.2021. Andaj gjykata duke u gjendur në këtë situatë ka vlerësuar se prokurori është dashur të paraqesë aktakuzë të re konform nenit 350 lidhur me nenin 252 par. 5 të KPRK-së pasi që ka rikualifikuar veprën penale, në mënyrë që gjykata të mund ta

vlerësoj pranimin e fajësisë saktësisht me provat që mbështet aktakuza e rikualifikuar si më lartë. Pasi që gjykata ka vendos që ta rihap seancën prokurorisë i ka dhënë mundësinë që të sjellë prova te reja nëse ka, meqenëse me rihapjen e seancës dhe revokimin e pranimit të pranimit të fajësisë Gjykimi konsiderohet i pa përfunduar dhe palëve nuk mund ti mohohet e drejta për te paraqitur prova të reja.

Vlerësimi i veprimeve të prokurorisë pas rihapjes në raport me dispozitat e KPPRK-së në lidhje me veprën e parë penale që i vihet në barrë të akuzuarit Sh.G.

Prokuroria Themelore në Gjilan me parashtrësë të datës 06 maj 2021 Gjykatës i ka propozuar që të caktohet një ekspert i balistikës i cili do të dëgjohet në seancë gjyqësore në rrethanat për krahasimin e armëve. Pastaj ka propozuar shikimin e sekuencave në kamerat e kompanisë G. A. në D., prej momentit të ndodhjes së rastit e deri kur zyrtaret kompetent të rastit e kanë ëshuar vendin e ngjarjes, si dhe ka propozuar që në cilësi të dëshmitareve të dëgjohej S. S., H. D., M.S. dhe A. H. të gjithë zyrtar policor të cilët kishin marrë pjesë ditën kritike në rastin konkret në këtë rast, qoftë në vendin e ngjarjes apo veprime të tjera.

Gjykata kishte caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale ashtu që në seancën e dt.07.05.2021, ku ka ftuar prokurorin që të sqarohet rreth kualifikimit juridik të aktakuzës, pasi më parë në seancë të dt.16.03.2022 ishte rikualifikuar vepra penale siç është cekur më lartë në fjalën përfundimtare.

Prokurori në seancë të datës 05.07.2021 (pas rihapjes) kishte deklaruar se mbetet pranë aktakuzës PP/I.nr. 89/2018 të dt. 12.06.2019. Prokurori sërish në seancë të rihapjes pas ndryshimit të përbërjes së trupit gjykues me dt. 06.10.2022, i ftuar që të lexoi aktakuzën e ka lexuar aktakuzën PP/I.nr. 89/2018 të dt.12.06.2019, dhe nuk e ka pasur fare parasysh se në seancën e dt. 16.03.2021 vetë prokuroria kishte bërë rikualifikimin e veprës penale ndaj të akuzuarit Sh.G. nga vrasja e rëndë nga neni 179 par 1 nën prg 1.5 të KPRK-se, në veprën penale vrasje nga pakujdesia nga neni 181 të KPRK-se. Shtrohet pyetje se a ka të drejte prokurori që pas rikualifikimit të bërë të kthehet prapë në aktakuzën e mëparshme pa asnjë provë të re dhe pa ndonjë njoftim apo arsyetim se prokurori paraprak i cili e kishte bërë rikualifikimin e veprës penale në favor të akuzuarit, ta ketë bërë me njëanshmëri dhe me çfarëdo shkelje ligjore, apo edhe vepër penale? A mjafton vetëm ndërrimi i prokurorit?

Megjithatë meqë gjykata nuk ka mekanizëm që ta detyroj prokurorin në leximin e aktakuzës Gjykata ka vazhduar shqyrtimin gjyqësor duke u rikthyer në procedurën e provave ku është dëgjuar dëshmitari - zyrtari policor S. S. pasi që paraprakisht kishte revokuar dhe pranimin e fajësisë siç u cek më lartë.

Të gjitha këto prova gjykata i ka administruar edhe në ri shqyrtim gjyqësor ku janë dëgjuar sërish ekspertët dhe dëshmitarët siç është cek edhe më lartë.

Gjykata vlerëson se duke pas parasysh rikualifikimin e bërë nga ana e prokurorisë pas administrimit të të gjitha provave në duhet të ndalemi vetëm në analizimin dhe arsyetimin e provave të cilat janë administruar pas rikualifikimit të bërë dhe pas rihapjes së shqyrtimit gjyqësorë, sepse provat e administruara deri në atë moment për të akuzuarin Sh.G. nga prokuroria janë kualifikuar si “vrasje nga pakujdesia”. A kishte prova të reja në shqyrtimin e rihapur? Prova këto që u administruan edhe në rishqyrtim gjyqësor.

Dëshmitari S.S. para gjykatës në rishqyrtim ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë në shqyrtimin e mëparshëm.

-Dëshmitari S.S. para gjykatës në shqyrtimin e më parshëm me dt.07.05.2021 kishte deklaruar se: ka dhënë deklaratë ne Inspektoratin policor ne Prishtinë, diku pas rastit 5 – 6 muaj. Ditën kritike ka qenë në punë në ndërrim të paradites nga ora 08:00/h deri ne 16:00/h, ka qenë në patrollë bashkë me H.D. sepse nuk ka patrollë vetëm, por duhet me qenë dy apo me shumë. Ka qenë diku te rrethi në D. i kanë thënë të shkonin te Kompania G. A. se ka ndodhur një rast, është lënduar një punëtor. Kanë shkuar e kanë takuar punëtorin Z. dhe dy vajza që kanë punuar aty, kanë parë njolla gjaku. Z. i ka njoftuar se djali i shefit e ka plagosur pahiri punëtorin. I kanë larguar menjëherë punëtorët prej aty ju ka ndihmuar edhe Z. sepse është punëtor me i vjetër nga se e njohin prej se ka filluar kompania ai ka qenë aty dhe çka kanë nevojë për shtëpi e blenë aty. Kanë marrë masa e kanë rrethuar vendin e ngjarjes e kanë mshel derën punëtorët i kanë qit jashtë dhe i kanë njoftuar njësitet e tjera. Pas pak kanë shkuar Njësia e D. dhe Njësia e P..

Këta brenda 5 minutave kanë rrethuar vendin e ngjarjes prej marrjes se vendimit, aty ka pasur punëtor dhe në podrum sepse ajo është kompani e madhe dhe brenda mundësive sa kane mundur e kane bere sigurimin e vendit te ngjarjes. Sa e kanë rrethuar vendin e ngjarjes kanë qenë dy vajza Z. dhe dy tre punëtor të cilët kanë dal. Një punëtor ka hy me një koleg te tij P. dhe e ka njoftuar se ku është arma dhe kanë pasur arsye për me ditë se ku është arma. Ky nuk është mbikëqyrës dhe as udhëheqës i grupit por vetëm patrollë. E ka lejuar kolegun P. nga se kur nuk ka polic me grada udhëheqës atëherë vendos ky qe ka numrin me te vogël është udhëheqëses nga se llogaritet se ka përvojë me shumë. P. nuk ka qenë mbikëqyrës i tyre sepse aty ka ardhur patrulla tjetër. Për me lejuar atë person me hyjnë në vend të ngjarjes nuk kanë marrë leje nuk kane pasur kohë me thirr mbikëqyrësin. Kolegu i ka njoftuar me raport, ky nuk i ka njoftuar por mjafton njeri. Kur është fjala për punëtor të cilët kanë dal jashtë i njëjti thekson se njeri prej tyre e ka pa kur ka dal e ka pasur një jakne në dorë e për të tjerët nuk e dinë. Nuk ka pyetur se kush është personi qe ka hyje me P. por kolega qe ka hyje ai e merr përgjegjësinë vet. Personi që ka hy është punëtori i tyre dhe sa e din është nipi i tyre ose familjarë. Nuk e ka pyetur P. se a e ka legjitimuar personin që ky hy aty. Se a është dashtë me lanë personin me hy aty ka qenë interes i rastit dhe nuk është ekspert edhe sikur ju të kishit qenë e kishit lejuar. Janë konsultuar P. kishte shkuar me atë personin dhe i kishte thënë se po don me treguar se ku është arma. Janë hi të dytë bashkë, nuk i di veprimet e personit që ka hy në vendin e ngjarjes sepse nuk ka hy me ta. Personi kishte hy pasi qe e kishin bërë rrethimin e vendit të ngjarjes.

Pasi qe është rrethuar vendi i ngjarjes kanë ardhur hetimet dhe ata e kane marrë rastin. Gjatë asaj kohe kanë qenë bashkë me H. D., ai i ka marrë shënimet ai ka shkuar se kush ka ardhur në vendin e ngjarës dhe ai ka përpiluar raportin, dhe gjatë gjithë kohës kanë qëndruar bashkë. Pasi qe ka dal P. me atë djalin i ka thënë hajde me pa se ku është dhe ky ka shkuar, P. e ka shty një farë ormani i ka pasur 3 – 4 fijoka ka qenë pak i qelur e ka shty me këmbë pastaj ka ardhur Njësiti i hetimeve për me u marrë me to. Kur ka ardhur Njësiti i hetimeve kanë ardhur si te gjithë për njëherë dhe dikush ju ka treguar se ku është arma nuk e di se kush e ka tërhequr armën sepse ky është larguar nga vendi i ngjarjes. Ky armën nuk e ka pa, armën nuk e ka prek, arma ka qenë nen kontrole, e mshelur dhe nuk ka pasur askush me prek sepse këta kanë qenë aty e kanë pas në shikim dhe kanë pa gjithçka brenda. Janë koleg i besojnë njeri tjetrit dhe nuk i takon me marrë armën nga vendi i ngjarjes, mjafton me ditë vend ndodhjen dhe këta i kanë njoftuar bartësit e tjerë. Ky nuk i ka besuar atij personit qe ka hy por i ka besuar kolegut të tij. Sa i përket këtij konsideron se ka vepruar ne mënyrën me të mirë

të mundshme. Inspektorati i ka gjetur disa shkelje por ajo është tjetër procedurë rasti është përfunduar. Para se të vi për deklaratë nuk ka biseduar me eprorin, ndërkaq gjatë pauzës dhe ngrënies së drekës është shoqëruar nga dy koleget e tij dhe atë H. dhe A. nuk kanë biseduar për rastin. Ditën kritike kur ka ndodhur rasti me dt. 23.09.2018 udhëqes i ndërrimit ka qenë M. S. ai ju ka thënë me shku në vend të ngjarjes, nuk ju ka dhënë urdhër sepse nuk ka nevojë me ju dhënë urdhër për veprimet që duhet ti ndërmarrim.

Më tutje i njëjti ka theksuar se e dinë se çka nënkupton fjala kontaminim i provave dhe nënkupton se dëmtohen provat në vendin e ngjarjes. Në rastin konkret ky ka vepruar konform rregullave dhe kushtet ndryshojnë sipas kushteve të vendit të ngjarjes. Në vend ngjarje sa ka qenë ky aty ka hy vetëm një person. Lidhur me atë që kishte deklaruar në Inspektorat se Z. ju kishte thënë se është lënduar një person pak në goj, dhe atë që ka deklaruar para gjykatës pak me lartë se Z. ju ka thënë se është plagosur një punëtor pahiri. Dëshmitari ka deklaruar se ka harruar se çka ka thënë. E në lidhje me atë që kishte deklaruar në Inspektoriale se emrat e atyre qikave dhe Z. i ka shkruar në një letër dhe ia ka dhënë letrën koleges, pasi që ky kishte shkruar te shtëpia e te dyshuarit me urdhër të prokurorit, i njëjti deklaroi se është e vërtete. Në vend të ngjarjes nuk ka pa diçka të dyshimtë as libër të dokumenteve të veturës libër e as mbështjellës të librave. Kur e ka thirr P. dhe i ka thënë hajde me pa fijoka ka qenë e hapur dhe nuk ka pa dikë qe e ka hap fijoken. Dëshmitari thekson se e saktë është deklarata që kishte dhënë në Inspektorat ku i njëjti ka theksuar se ai punëtori i cili kur e ka hapur dollapin e ka pa vetëm një çantë me logo e veturës O.dhe ka menduar se ka qene arma me të cilën dyshohet se e kishte plagosur A. T., por kur kanë ardhur Hetimet Rajonale ka vërejtur se në atë çantë ka qenë arma me gaz ndërsa arma te cilën e kishte qëlluar Sh.i A. T. ishte armë tjetër. Çanta nuk ka qenë e dedikuar për armë. Nuk e di se ku ka mbetur arma me gaz pasi qe ky ka shkruar me herët. Është e saktë ajo qe kishte deklaruar në atë deklaratë se kanë vepruar në bazë të mundësive mund të ketë ndodhur gabime por pa qëllim, sepse fillimisht ka qenë informata e lëndimit pa pasur informata të gjuajtjes me armë, dhe kur e kanë marrë informatën e gjuajtjes me armë e kanë siguruar vendin e ngjarjes.

Nuk është rasti i parë që kanë dal në vend të ngjarjes, kanë vepruar aq sa e kanë lejuar rrethanat, nuk janë ndikuar nga askush, H. atë ditë nuk e kanë parë hiq, me Sh.in nuk janë takuar, dhe këta nuk e kanë arrestuar, po ashtu nuk kanë komunikuar as me I.. Ky personalisht nuk është afruar me pa çantën dhe me pa logon e saj. Ka mundësi ta këtë ngatërruar Logon e M.me logon e O.ngase nuk i ka kushtuar rendësi dhe forma është e njëjte si rrumbullaket. Çanta ka mbetur aty, ky nuk ka qenë aty kur hetuesit e kanë nxjerr çantën. Njëra prej vajzave që e kanë gjetur aty e kanë pyetur se a ka mundësi me shku të dollapi me tërheq parat, ky i ka dhënë leje por parat janë tërhequr prej fijokut të parë nalte dhe ka qenë i qelur dhe këtë e ka parë personalisht. Të hollat kanë qenë në një zarf dhe ka pa që ka pasur shumë para, ngase aty ka qenë prezent. I njëjti e konfirmon se ka qene prezent pasi që e shiqon edhe video incizimin e momentit në ora 11:17 min. Nuk është tërhequr diçka tjetër. Mbikëqyrësi i ndërrimit M. S. nuk ka qenë në vendin e ngjarjes. Ndaj tij në Inspektoriale është zhvilluar një procedurë disiplinore dhe është shpallur përgjegjës ashtu që ju është bërë vërejtje në standarde në lidhje me personin qe kanë lejuar me hy në vendin e ngjarjes nuk i kujtohet saktësisht si është kualifikuar shkelja. IPK-ja nuk ka gjetur shkelje dhe çështja ka kaluar në standarde ku dhe i është shqiptuar vërejtja. E thotë me përgjegjësi se nga askush nuk i është kërkuar që të ndryshohen provat në vendin e ngjarjes. Vendi i ngjarjes nuk ka mbetur pa mbulesë të zyrtareve policor, në video në ora 11:46 minuta shihet ky dhe P.dhe i njëjti deklaroi se unë e kam mbyllur fijoken me këmbë dhe në atë moment ky e ka parë çantën me logo dhe momentin kur ka shkruar ky P.me atë personin kishin dal prej aty, ai personi kur ka hyje nuk ka pasur asgjë në dorë. Me pas vendin e ngjarjes ka ardhur Prokurori dhe kur prokurori kishte shkruar në

vendin e ngjarjes dhe lokali ka qenë i zbrazur nga punëtorët dhe ky ka qëndruar aty deri sa kishin ardhur të dy palët hetuese nga Stacioni Policor në D. dhe nga Stacionit Policorë në Pejë.

Dëshmitari **H.D.** para gjykatës në rishqyrtim ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë në shqyrtimin e mëparshëm.

Në seancën e dt. 28.06.2021 janë dëgjuar zyrtarët policor ne cilësi te dëshmitareve H.D. dhe A. H..

-Dëshmitari **H.D.** para gjykatës në shqyrtimin e mëparshëm me dt.28.06.2021 kishte deklaruar se palët në procedurë i njuhë si qytetar të D.. Për këtë rast ka dhënë deklaratë në IPK dhe në Standarde dhe pasi që shiqon procesverbalin e dt.8.12.2018 i njëjti thekson se është deklarata e tij dhe mbetet pranë asaj deklarate. Ditën kritike prej orës 8:00 në mëngjes deri në ora 16:00 mbas dite kanë pasur orarin dhe rrethe orës 11: 05 apo 11:10 minuta janë informuar prej bazës së është një incident në firmën G. A. dhe kanë shkuar me kolegun S. S. me pyet se çka ka ndodhur. E kanë pyet punëtorin Z. T. dhe i njëjti ka informuar se qeshtu Sh. e ka plagosur pa hiri A. dhe kur kanë shkuar aty e kanë pa gjakë, janë munduar sa kanë mundur me i qit punëtorët jashtë. Kur këta kanë shkuar në vendin e ngjarjes nuk ka qenë as viktimas kryesi, kanë pyetur për viktimën, ju kanë thënë se e kanë dërguar në spital disa punëtor. Në atë moment i kujtohet se kanë ardhur edhe disa koleg R. B. dhe P. M.. I kanë qit punëtorët jashtë e kanë rrethuar vendin me shirita. P. ka shkuar me siguru kryesin e veprës në objekt më poshtë dhe Skenderi ka qëndruar te dera kryesor ku ka ndohur rasti dhe ky e ka siguruar një pjesë më poshtë për mos me hyrë dikush në vendin e ngjarjes. Në vendin e ngjarjes kanë arritur pas 15 minutave. Në vendin e ngjarjes ka hy P. me një person tjetër që mendon se është miku i të akuzuarit I. me u siguru për armën se ku është. P. është polic patrullues. Vendin e ngjarjes janë munuar me siguruar konfom rregullave të brendshme dhe Kodit të Procedurës Penale. Kur ka hy P.me atë person ky nuk e ka pa, por ka kuptuar më vonë. S. ka mbajt shënime për vendin e ngjarjes ia ka jep këtë atë letër deri sa kur ka dhënë urdhër prokurori me shku të shtëpia e G..

Më vonë e ka kërkuar atë letër po nuk e ka gjetë, në atë letër kanë qenë vetëm emrat se kush ka qenë në vend të ngjarjes. Ky e ka bërë raportin dhe e ka konstatuar vetëm personin e parë dhe i ka përshkuar edhe veprimet e tjera, por nuk përfshijnë edhe personat e tjerë që kanë hyrë dhe dal në vendin e ngjarjes. Ndërkaq e ka konstatuar bisedën që ka pas me personin Z.. Në raport ka shënuar që është plagosur me armë zjarri dhe nuk e ka shënuar pa hiri apo me kast.

Më tutje i njëjti ka deklaruar se ndoshta ka pas ndonjë lëshim në vendin e ngjarjes por jo shumë dhe mendon vetëm se ka hy ai personit, por ky nuk e ka ditë që ka hy. Nuk ka marr urdhër prej eprorit-përgjegjësit se si të veprojnë në vendin e ngjarjes, në atë kohë eprorë e ka pas M.S.. Ky nuk e ka vërtetuar se ku ka qenë arma. Ma vonë është informuar se është gjetur edhe një armë tjetër dhe duhet të hapin rastin. Nuk i kujtohet sa persona të pa autorizuar kanë hy ditën kritike në vendin e ngjarjes. Ky atë ditë që ka ndodhur vrasja e ka përpiluar edhe raportin. Këta e bëjnë një raport të shkurt dhe pastaj rasti kalon në hetime regjionale të cilët veprojnë në raste të ndjeshme. Në vendin e ngjarjes sa ka qenë e ka kontaktuar udhëheqësin e ndërrimit në atë kohë M. S. dhe radio operatorin S. B. që në atë kohë ka qenë staf civil. Ky nuk ka marr ndonjë urdhër apo kërkesë për të prish vendin e ngjarjes apo manipuluar provat. Nga askush nuk i është kërkuar me i ndërruar provat në vendin e ngjarës. Ky ka qenë në vendin e ngjarjes deri në orën 12:00 dhe pastaj ka shkuar në stacion, kur ky e ka lëshuar vendin e ngjarjes, aty kanë qenë hetuesit e stacionit Policorë në Pejë dhe Prokurori dhe dy hetuesit e stacionit policorë në D.. Hetuesit e Stacionit Policorë në D.kanë ardhur para prokurorit të shtetit dhe hetimeve rajonale.

Për shkelje të detyrave që kanë ndodhur në vendin e ngjarjes ka dhënë përgjegjësi në Standarde profesionale, por jo pse nuk i ka shënuar emrat në raport. E kur ka shkuar në IPK e ka kuptuar se në vendin e ngjarjes kishte kamera. Ky brenda lokalit kur ka shkuar dhe deri sa i kanë qit personat jashtë ka qëndruar diku 10-15 minuta dhe këtë e ka konstatuar në bazë të kamerave. Kur ka shkuar në IPK i ka pa në kamerë personin që hynë në lokal dhe ai ka qenë miku i Isufit dhe nuk i kujtohet se çka ka pas veshur. Nuk i kujtohet se kur e ka kuptuar se është gjetur arma e dytë por i duket se gjatë ndërrimit. E R. B. dhe M. B. e kanë marrë të akuzuarin Sh. nga vendi i ngjarjes

Dëshmitari **A. H.** para gjykatës në rishqyrtim ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë në shqyrtimin e mëparshëm.

-Dëshmitari **A. H.** para gjykatës në shqyrtimin e mëparshëm me dt. 28.06.2021 dhe me dt.06.10.2022 ka deklaruar se: për këtë rast ka dhënë deklaratë në IPK në cilësi të dëshmitarit. Nuk e mbanë mend se prej kujt është njoftuar për rastin por zakonisht informacionet i marrin nga Qendër, nëse jo prej aty atëherë prej njësisë së hetimeve. Në momentin kur e ka pranuar informatën është nisur me shku në vendin e ngjarjes ka mundësi prej orës 13:00 ose 13:30. Kur ka shkuar në vendin e ngjarjes ka qenë një numër i policëve të D. që nuk i njehë mirë, disa polic hetues prej hetimeve regjionale bashkë me forenzik, shefi i njësisë për hetime të vrasjeve R.M. dhe mbikëqyrësi i tij E. Ll. Vendi ishte i siguar, informatat e para në vendin e ngjarjes i ka marrë prej shefit të njësisë R.M. dhe mbikëqyrësit të tij E. Ll. Aty rryma ka qenë e ndalur edhe pse ka mbërri dy orë me vonesë dhe kamerat janë lëshuar një orë më vonë dhe aty kemi pranuar informacione se si ka ndodhur ngjarja. Rasti ka qenë shumë i rëndë dhe ka qenë i njoftuar fillimisht se ka ndodhur një vrasje dhe shumë rrethana kanë qenë të pa qarta në momentin që kanë parë videon janë qartësuar shumë gjana. Rryma kishte ardhur ndoshta pas 15-20 minuta dhe kamerat e kanë pa aty për aty. Stafi kanë kontaktuar me pronarë nga se rrym nuk ka pas vetëm aty. Nuk e di sa kohë nuk ka pas rrymë.

Më tutje i njëjti ka deklaruar se inicimi fillestar i procedurës disiplinore është filluar prej tij dhe prej prokurorisë dhe kanë një shkresë zyrtare që beson se duhet me qenë në dosjen e IPK-së. Ky e ka nisur hetimin disiplinor dhe në këtë rast Komandanti i stacionit Policorë në D.i ka qar dosjet me kërkesën e tij dhe në kuadër të ati hetimi është ftuar si dëshmitar dhe me sa është informuar nuk janë gjetur fajtor penalisht. Policët në aspekt administrativ disiplinor janë ndëshkuar me masa së paku në shkallën e parë, nëse ka ndërruar shkalla e dytë nuk është i informuar. Kur ky e ka iniciuar procedurën disiplinore nuk ju ka ditë emrin policeve, por komandanti i Stacionit Policorë e ka për detyrë dhe i ka identifikuar në bazë të kamerave dhe ua ka siguruar emrat.

Ka arritur në vendin e ngjarjes nuk ka pasur rrymë, vetëm në atë lokal dhe ka qenë e rëndësishme me kthyer rrymën dhe me vazhdu punën, pjesa tjetër ka qenë detyrë e hetuesve dhe stafit te tyre. Për rastin në parim raportin e përpilon hetuesi, polici apo mbikëqyrësi i rastit. Raporti prej mbikëqyrësit nënshkruhet edhe në rastet e tjera kur dërgohet në prokurori dhe në Gjykatë. Çdo raport nënshkruhet nga përpiluesi, ndërkaq raporti i vendit te ngjarjes nënshkruhet nga forenzika dhe mbikëqyrësi i forenzikes, nuk nënshkruhet nga ky.

Në vendin e ngjarjes janë gjetur dy armë, një armë me gazë dhe një armë me të cilën është kryer vepra. Paraprakisht është gjetur arma me të cilën është kryer vepra. Në vendin e ngjarjes kanë qenë të gjithë personat që janë shënuar në raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes. Arma me të cilën është kryer vepra është gjetur fillimisht e dyta është gjetur menjëherë kur është

kontrolluar vendi i ngjarjes. Nuk është shënuar në raportin e këqyrjes dhe është një mangësi teknike që nuk është konstatuar dhe se është gjetur edhe arma tjetër janë të gjitha raportet në shkresat e lëndës. Ka konsideruar se D. do të merret me rastin dhe kjo është e konstatuar edhe në kallëzimin penal që është përpiluar të nesërmen dhe shumë raporte të tjera. Armbajtja pa leje është kompetence e Stacionit policor në D.. Në atë kohë ka qenë në pyetje a me bo bashkë a me proceduar apo me i nda. Ide ka qenë se nuk lidhet me rastin arma dhe ky është pajtuar që të mbetet në Stacion policor në D.. Kanë biseduar me rreshterin R. dhe me kapitenin E. dhe vendimi ka qenë që me ja lënë D.it. Është iniciuar si rast dhe se i kanë rregulloret e brendshme që i rregullojnë kompetencat dhe nëse gjendet në Klinikë merret Klina, nëse ndodhë në Istog merret Istogu, varësisht prej rrethanave. Në momentin që rreshteri R. e ka njoftuar se i dyshimti mbrojtjen e tij po e lidh me armën me gaz në vendim të tij ka vendosur që të lidhet lënda dhe pastaj të gjitha shkresat e lëndës janë dërguar në prokurori. Fillimisht prokurori i rastit ka qenë Haxhi Sinanaj e pastaj ka qene prokurorja Sahide Gashi.

Më tutje sërish lidhur me kamerat i njëjti thekson se në lokal nuk ka pasur rryme nga se deri sa ka shkuar ky nuk ka mundur me i pa kamerat, mandej i kanë lëshuar kamerat i kanë pa dhe prokurori Haxhi Sinani paraprakisht ka qenë në vend të ngjarjes, ky e ka njoftuar se kanë arritur me leshu rrymën dhe përmes telefonit e ka njoftuar se i ka lëshuar kamerat dhe ka qenë sugjerim i tij që ai me ardh me i pa kamerat, pastaj ky ka shkuar por sa e di ai ka shkuar ne vendin e ngjarjes dhe i ka pa kamerat. Ky nuk është pa me prokurorinë dhe nuk e di se a i ka thirr ai KEK-un për me leshu rrymën. Nuk e di se a ka pasur kamerat inventor gjate gjithë kohës sa ka qenë ky brenda, me këtë punë janë marrë hetuesit dhe ata e dinë se a ka pasur shkepËtje. Nuk e di se kush e ka gjetur armën me gaz por e di që është gjetur ne tavolinën e njëjtë. Arma është gjetur në sirtarin e dytë por nuk e di saktësisht për të ekzistojnë raportet dhe nëse në raport është shënuar se arma është gjetur në sirtarin e tretë, atëherë është e saktë.

Të nesërmen pas rastit stafi i ka analizuar kamerat në detaje dhe në momentin që i kanë pa lëvizjet e policeve e kanë informuar se është mirë me pa disa detaje që shihen në kamera sepse nuk ka shkuar gjithçka në rregull. Për sigurimin e vendit të ngjarjes nga ana e policisë në D.për shkak se kanë lejuar me hy persona njerëz civil e po ashtu edhe vet policet nuk kanë pasur nevojë e as autorizim me bo rrëmuje vendin e ngjarjes, pikërisht te tavolina ku ka qenë vendi i ngjarjes dhe në atë kohë kanë konsideruar se kanë bërë edhe vepër penale e jo disiplinore sepse e kanë dëmtuar vendin e ngjarjes. Prej tij ka qenë me kërkuar hetime dhe jo me i zbatuar nga se me këtë punë është marrë IPK-ja dhe Prokuroria. Vendi i ngjarjes nuk është ruajtur sipas procedurave nuk kanë pasur të drejte e as autorizim me i bo ato veprime dhe ky për këtë arsye ka kërkuar hetim e nuk ka bo konstatim se kanë kryer vepër penale, sepse nuk i takon këtij. Vendi i ngjarjes dëmtohet nëse nuk shkon sipas procedurave, lëvizja e mjeteve mund të fshihet dhe në këtë rast ka ndodhur realisht. Në këtë rast se a ka pasur pasoja apo jo i takon dikujt tjetër, mirëpo dëmtim të vendit të ngjarjes dhe kontaminim të vendit të ngjarjes ka çdo herë kur hynë dikush dhe prek në çfarë mase nuk mundet me thënë. Kur i ka pa përmes kamerave bashkë me stafin ka qene një situatë e pa këndshme për shkak se rasti ka qene i rëndë dhe ata ne asnjë moment nuk kanë guxuar me bo ato veprime. Sikur këta polic te mos i kishin bo lëvizjen që i kane bo, atëherë nuk kishin me ardh te këto dilema dhe do te ishte me lehte për të gjithë sepse ne këtë rast kryesi është ditur dhe është pa.

Futja e armës ka ekzistuar si dilemë e përgjithshëm nuk e ka pa si dilemë të shkruar por dikush e ka ngritur. Për këtë punë janë bërë hetime. Nga raporti i prokurores Sahide Gashi kur ka përfunduar hetimet ndaj policisë është konstatuar se policet që kanë siguruar vendin e

ngjarjes nuk kane kryer vepër penale. Dilemën e futjes se armës e ka hetuar IPK dhe Prokuroria si dhe hetimet regjionale mirëpo për shkak se kamerat kanë qenë të vendosura me lartë nuk ka mundur me vërejt se çka po hin dhe çka po del në sirtar. Ky kamerat i ka pa por nuk i ka pa në detaje por vetëm pjesët kur kryhet akti, do të thotë prej momentit kur e ka marrë revolen deri në momentin kur e ka shkrepur armën. Sa i kujtohet shihet ajo pjese kur e merr revolen pjesërisht. Te gjitha raportet janë përpiluar dhe ky zakonisht i lexon dhe për këtë rast ka qene e njëjtë bisedohet me stafin krejt çka ka shkuar mire dhe jo mire dhe pasi qe është informuar se është kontaminuar vendi i ngjarjes e ka kryer pjesën e përgjegjësisë se tij për të zhvilluar një hetim. Raportet e armëve sa e din nuk ka rezultuar me gjurmët e gishtave ne armë dhe policet janë ndëshkuar për shkak se e kanë dëmtuar vendin e ngjarjes dhe pasojat nuk i di.

Dëshmitari *M. S.* para gjykatës në rishqyrtim ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë në shqyrtimin e mëparshëm.

-Dëshmitarit *M.S.* para gjykatës në shqyrtimin e mëparshëm me dt. 06.10.2022: ka deklaruar se nuk ka dhënë me herët e deklaratë për këtë rast, ka përpiluar një raport fillestar apo një raport të shpejte për Qendrën Operative në Pejë pasi qenë rasti ka ndodhur gjatë ndërrimit të tij. Ditën kur ka ndodhur ngjarja me dt. 23.09.2018 ka qenë mbikëqyrës i ndërrimit. Ditën kritike është njoftuar për rastin nëpërmes telefonit nuk i kujtohet se kush e ka njoftuar por ka qenë informata qe është një plagosje në kompleksin G.. Menjëherë e ka qu patrullën në vendin e ngjarjes dhe ky nuk ka qenë në vendin e ngjarjes fare nga se nuk ka mundur me shku. Raporti i shpejt është ai të cilin ja jep prokurori për shikim dhe me rast pastaj janë marrë hetimet rajonale, për nga rendi se pari behet raporti i shpejt e pastaj vjen pjesa tjetër. Të dhënat qe janë shënuar në raportin e shpejt të dt.23.09.2018 i kanë marrë prej patrullave dhe policeve që kanë qenë në teren. Raporti i shpejt i marrë prej policeve nuk mundet me qene asgjë 100 % për shkak se merren hetimet me vonë. Pas marrjes se informacionit përpilohet raporti i shpejt e pastaj është njoftuar Peja me anë të shkresave nga Eproret e Stacionit policor të D., mirëpo atë ditë Eproret e Stacionit Policor të D. i kanë njoftuar por ka qenë ditë pushimi dhe asnjë nuk ka qenë në vend të ngjarjes. Pas daljes së policeve në vendin e ngjarjes nga Peja ky nuk ka bërë asnjë veprim tjetër. Nga kolegët me të cilët ka bo biseda telefonike i kanë thënë se i kanë gjetur dy armë ky ato armë nuk i ka parë por ata i kanë bërë raportet e veta. Nuk e di saktësisht se kur është njoftuar se janë gjetur ato dy armë por e ti ka qenë që pas marrjes se informacionit që mendon se rasti ka ndodhur rreth orës 11:20/h por qe nuk i kujtohet saktësisht, detyrë e tyre ka qenë vetëm me bo sigurimin e vendit të ngjarjes. Në vend të ngjarjes kanë qenë dy patrulla për te siguruar provat qe duhet ruajtur. Ky nuk ka qenë aty, ata që kanë qenë në vendin e ngjarjes kanë qenë polic me përvojë nuk e di se çka kanë bërë aty dhe nuk ka informata se është kontaminuar vendi i ngjarjes. Për rastin e ndodhur e ka telefonuar dikush nga punëtoret e kompanisë G. A., në telefon zyrtar të policisë. Ka qenë në Stacion Policor kur e kanë sjellë të akuzuarin Sh.G. nuk e ka marrë në pyetje, nuk ka biseduar me të. Dy policë e kishin sjellë ky ju ka thënë me dërguar në dhomë lartë dhe me qëndruar me te deri sa të vi njësitit për transferimin e tij në regjionin e Pejës. Sa i kujtohet ata policë kanë qenë R. B. dhe M. B., të akuzuarin e ka pa vetëm kur ka hyj dhe kur ka dal.

Pas dëgjimit të dëshmitarit është shikuar serish video incizimi i ditës kritike prej momentit të ndodhjes së rastit dhe deri në përfundim kur edhe paraqiten zyrtaret policorë dhe prokurori.

Në seancën e dt.06.10.2022 shqyrtimi gjyqësor kishte vazhduar me administrimin e provave materiale. Paraprakisht gjykata ka refuzuar propozimin e prokurorit që në këtë çështje të ftohet

eksperti i balistikës, ashtu që të bëhet krahasimi i armëve. Këtë propozim gjykata e kishte refuzuar sepse paraprakisht janë dëgjuar ekspertet balistike dhe ri dëgjuar, ku dhe drejtpërdrejtë në gjykatë janë sjellë armët është bërë krahasimi ku eksperti L.R. në prezencë të palëve në seancë publike ka përcaktuar dallimet dhe ngjashmëritë e të dy armëve. Andaj gjykata ka vlerësuar si të panevojshme që serish të bëhet krahasimi i armëve.

A kishte prova të reja në shqyrtimin e rihapur në mënyrë që prokuroria të ketë mundësin e ndryshimit të aktakuzës në dëm të akuzuarit Sh.G.?

Gjykata ka vlerësuar se Shiqimi i vido-incizimit dhe dëgjimi i dëshmitarëve, S.S., H.D., A. H. dhe M.S. nuk janë prova të reja. Video-incizimet e njëjta janë administruar edhe më parë në shqyrtim gjyqësor. Ndërkaq, dëgjimi i zyrtarëve policorë po ashtu nuk ishin prova të reja, për shkak se të njëjtit në shkresat e lëndës i kishin raportet e tyre, të cilat janë propozuar nga prokuroria dhe janë administruar si prova në shqyrtim para rihapjes, do të thotë kanë qenë dëshmitarë të njohur për prokurorinë dhe po ashtu edhe nga vido-incizimi shifen prezencën dhe veprimet e tyre në vend të ngjarjes. Prokuroria po ashtu edhe më parë kishte njohuri se ndaj zyrtarëve policorë S.S. dhe H.D. iu kishte shqiptuar masë disiplinore nga Standardet, ndërkaq nga Inspektorati Policor nuk ishin gjetë elemente të veprës. Se këto prova ishin të njohura për prokurorin vërtetohet nga se më parë në shqyrtim ishte dëgjuar dëshmitarit P.M. i cili ka deklaruar se ishte dëgjuar në cilësi të dëshmitarit në Inspektorat dhe se policëve në fjalë ju ka shqiptuar masë nga standardet, ndërkaq dëshmitari A. H. thekson se prokuroria kishte pushtuar hetimet ndaj policëve pasi që nuk janë vërtetuar elemente të veprës penale nga Inspektorati policorë.

A është njoftuar gjykata për arsyet e ndërrimit-largimit të prokurorit Agron Uka pas rihapjes së seancës apo për ndonjë veprim të prokurorisë në këtë drejtim?

Nga rihapja e shqyrtimit gjyqësor me dt.19.03.2021 Gjykata përkatësisht trupi gjykues nuk janë njoftuar për arsyet e largimit të prokurorit Agron Uka dhe ardhje së prokurorit Isuf Sadiku, për përfaqësim të aktakuzës në këtë rast. Nuk është njoftuar gjykata nëse është zhvilluar ndonjë procedurë dicitpline apo për kishte ndonjë shkak për largimin e tij. As në fjalën përfundimtare nuk janë dhënë arsye dhe as sqarime siç është pretenduar në shkresën e prokurorit të shtetit të dt.18.03.2021, nëse është shqyrtuar paanshmëria dhe profesionalizimi i prokurorit me rastin e rikualifikimit. Për prokurorinë në shqyrtimin e rihapur, rikualifikimi i bërë nga prokurori i mëparshëm Agron Uka si në seancën e dt.16.03.2021, është konsideruar si “in existent”. Ngase prokuroria në asnjë moment nuk e përmend dhe nuk e jep asnjë arsye apo vlerësim sa i përket rikualifikimit të veprës në vrasje nga pakujdesia nga neni 181 të KPRK-së.

Sipas vlerësimit të gjykatës në rrethana të tilla prokuroria pa pas bazë ligjore dhe pa prova të reja nuk ka të drejtë ligjore të qëndroi serish pranë aktakuzës së dt.12.06.2019 të cekur si me lart. Pasi që në seancë të dt.16.03.2021 ka bërë rikualifikimin veprës penale vrasje e rendë nga neni 179 par. 1 nen par.1.5 të KPRK-se, në vepër penale vrasje nga pakujdesia nga neni 181 të KPRK-së, në favor të akuzuarit. Prokurori pas rikualifikimit të veprës me rastin e rihapjes së seancës ka pas mundësi të sjell prova të reja që nuk kanë qenë të njohura më parë dhe tek pas kësaj pas vërtetimit të ndonjë gjendje faktike tjetër ka mund të bëjë serish rikualifikim te veprës penale konform nenit 252 par. 5 të KPPRK-së. Por, assesi të mbetet pranë aktakuzës së mëparshme. Pasi që konsiderohet se prokuroria me dt.16.03.2021 atë aktakuzë në një farë mënyre e ka tërhequr duke akuzuar të akuzuarin Sh. G. për një vepër penale në favor të tij në këtë rast vepër penale vrasje nga pakujdesia nga neni 181 të KPRK-së.

Gjykata duke analizuar dhe vlerësuar këtë çështje ligjore ka vlerësuar dhe analizuar dispozitat ligjore dhe atë nenin 252 par.5 (aktakuza mund të ndryshohet një herë dhe pastaj mund ta ndryshoj vetëm nëse paraqiten fakte dhe prova të reja) dhe neni 350 të KPPRK-së (po ashtu

parashihet ndryshimi i aktakuzës nga prokurori), këto dispozita i ka vlerësuar në raport me dispozitën e nenit 3 par. 2 të KPPRK-se, ku parashihet se: “mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të pandehurit sipas këtij kodi dhe sipas Kushtetutës së republikës së Kosovës.

Vlerësimi përfundimtarë i gjykatës

Andaj gjykata duke u gjendur në një situatë të tillë nuk është lëshuar në vlerësim dhe nuk ka paraqitur arsyet lidhur me analizimin e provave në raport me gjendjen faktike as i përketë provave të paraqitura deri në rikualifikim e bërë nga ana e prokurorit.

Në rastin konkrete bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vlerësuar mbrojtjen e të akuzuarit *Sh.G.* dhe marrë parasysh veprimet procedurale të prokurorisë, ka ardhur në përfundim se gjykata nuk mund të veprojë në dëm të akuzuarit dhe të akceptojë pretendimet e prokurorisë pas asnjë bazë ligjore dhe të anashkalojë dispozitat ligjore. Kur kodi i procedurës penale përcakton kushte dhe rrethanat kur mund të ndryshoj aktakuza në dëm të pandehurit gjatë shqyrtimit gjyqësorë, apo edhe me përsëritje të procedurës kur plotësohen kushtet e përcaktuar ligjore. Andaj, dilemat apo mëdyshjet lidhur me veprimet e prokurorit në raport me aktakuzën dhe rikualifikimin është dashur gjykata ti interpretojë në favor të akuzuarit. Andaj, gjykata ka vendosur që i akuzuari *Sh.G.* duhet të shpallet fajtor për veprë penale të vrasjes nga pakujdesia konform neni 81 të KPRK-se, (pra merr për bazë rikualifikimin e veprës nga prokuroria në favor të akuzuarit me dt.16.03.2021), dhe veprë penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së. Vepra këto për të cilat i akuzuari *Sh.G.* i ka pranuar.

Lidhur me të akuzuarin *I.C.* gjykata ka vlerësuar si të pa qëndrueshëm pretendimin e tij se nuk e ka ditë se për armën me gazë duhet marrë leje nga se me provat e tjera të administruara u vërtetua e kundërta e pretendimeve të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij.

Nga fotografit e vendit të ngjarjes dhe nga vido-incizimi vërehet se me dt.23.09.2018 në lokalitetin “G. A.”, pikërisht në fijosk te arka ishte arma B. me gazë, për të cilën i akuzuari *I.* ka deklaruar se është e tij.

Pretendimi se nuk ka pas njohuri se duhet marrë leje, gjykata nuk ia falë besimin mbrojtjes së të akuzuarit, bazuar në faktin se i akuzuari *I.* kishte edhe armë me leje, do të thotë ka pasur të njohura procedurat e marrjes së lejes për armë, në qoftë se i njëjti do të kishte interes për mbajtjen e armës i njëjti shumë lehtë të informohej.

Bazuar në të lartë cekurat për të akuzuarin *I.C.* gjykata ka vlerësuar se në veprimet e tij janë përmbushur elementet e veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Denueshmëria e veprave penale dhe vendimi mbi dënimin

Sipas neni 181 Vrasja nga pakujdesia parasheh: “*Kushdo që e privon nga jeta personin tjetër nga pakujdesia, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet*”.

Sipas nenit Neni 374 Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve parasheh:

1. *“Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet”.*

3. *” Arma në pronësi, kontroll apo posedim në shkelje të këtij neni konfiskohet”.*

Gjykata konform nenit 73 dhe 74 të KPRK-së ka vlerësuar rrethanat për dënimin në raport me veprat penale të përcaktuara me dispozitat ligjore të cekura më lartë dhe dënueshmërin e tyre.

Për të akuzuarin Sh.G. ka vlerësuar se i njëjti në kohën e kryerjes së veprës penale ishte i moshës së re, kishte moshën 18 vite e katër muaj e tri ditë, shprehjen e keqardhjes. Nga rrethanat rënduese ka vlerësuar mënyrën dhe vendin ku i akuzuari ka kryer veprat penale, se i njëjti kishte shtënë me armë në vendin e punës ku kishte privuar nga jeta viktimën A.T. në vendin e tij të punës duke kryer detyrat e tij të punës, pa pasur ndonjë të keqe nga ai, si dhe faktin se e përdorë armën i vetëdijshëm se nuk është në ndonjë poligon apo vend gjuetie, por ka qenë në vende të punës ku më së paku pritej të përdorej arma.

Gjykata e ka vlerësuar edhe aktvendimin ku të akuzuarit Sh.G. i është shqiptuar edukim i mbikëqyrur nga ana e prindit por meqë ka qenë veprë e kryer në kohën kur ka qenë i mitur, një aktvendim i tillë nuk mund të vlerësohet si rrethanë rënduese në kohën kur i akuzuarit veprat penale i kryen si madhorë.

Pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit Sh.G. av. Besnik Berisha, lidhur me caktimin e dënimit ku propozon që gjykata me rastin e caktimit të dënimit të merr parasysh dënimet e deritanishme të caktuara nga gjykata për veprat penale të ngjashme, gjykata nuk e mori për bazë, për shkak se secili rast është rast individual dhe dënimi caktohet dhe individualizohet duke marrë për bazë rrethanat dhe specifikat e rastit konkret.

Për të akuzuarin I.C. nga rrethanat lehtësuese ka vlerësuar se i njëjti është familjarë dhe shprehjen e keqardhjes. Nga rrethanat rënduese gjykata ka vlerësuar se i njëjti armën e kishte mbajtur në fijokë në dyqan ku dhe punonte i njëjti e ku kishte edhe punëtor dhe persona të tjerë që e frekuentonin të tjerë. Me rastin e caktimit të dënimit për të akuzuarin I.C. gjykata mori për bazë edhe gjendjen e tij ekonomike, meqë me dispozitën e nenit 73 par. 5 parashihet që *“gjykata me rastin e caktimit të dënimit me gjobë merr parasysh edhe gjendjen pasurore të kryerësit....”.*

Duke vlerësuar rrethanat për dënimin e veçanërisht ato rënduese që u ceken më lartë, gjykata i vlerësoj se caktimi i dënimeve për veprat penale për të dy të akuzuarit janë në përputhje me shkallën e përgjegjësisë së tyre penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe gjykata është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarve në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Të dëmtuarit I.T. dhe N. T, e dëmtuara A.C. në cilësi edhe të përfaqësueses ligjore të dy fëmijëve të saj të mitur për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil konform nenit 463 të KPPRK-së.

Të dëmtuarit A.H. dhe F.Z. kanë deklaruar se nuk ndjehen të dëmtuar nuk kanë kërkesë për dëmshpërblim.

Vendimi mbi konfiskimin

Vendimi mbi konfiskimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u mor konform nenit 374 par. 3 lidhur me nenin 62 par 1. dhe 2 pika 2.7 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësorë

Duke u bazuar në nenin 450 të KPPRK-së, i obligoi të akuzuarit secilin veç e veç që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor.

Vendimi mbi kompensimin e viktimave të krimit

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit e obligoi të akuzuarit secilin veç e veç që ti paguajnë shumën e cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi paraburgimin

Pas shpalljes së aktgjykimi të akuzuarit i është vazhduar masa e paraburgimit dhe arsyet për këtë janë dhënë në aktvendimin PKR.nr.50/23 të dt.15.03.2024.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,**

2018:057911, 14.05.2024

**Aktgjykimi u përpilua nga
Kryetarja e trupit gjykues**

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.